

UNGJILLI SIPAS MATEUT

Jezusi, pikësynimi i historisë së Izraelit

(Lk 3.23-38)

1 Jezusi, Mesia, është pasardhës i Davidit dhe i Avrahamit. Këtu është gjenealogjia e tij: ♦
²Avrahamit i lindi Izaku. Izakut i lindi Jakovi. Jakovit i lindi Juda me vëllezërit e tij. ³Tamarës së Judës i lindën Perci dhe Zerahu. Percit i lindi Hecroni. Hecronit i lindi Rami. ⁴Ramit i lindi Aminadavi. Aminadavit i lindi Nahshoni. Nahshonit i lindi Salmoni. ⁵Nga Salmoni dhe Rahava lindi Boazi. Boazi dhe Ruta lindën Ovedin. Ovedit i lindi Jishai dhe ⁶Jishait i lindi mbreti David.
⁷Solomoni ishte biri i Davidit dhe i ish-gruas së Urijës; Rëhavami ishte biri i Solomonit. Rëhavamit i lindi Avija. Avijës i lindi Asa. ⁸Asës i lindi Jëhoshafati. Jëhoshafatit i lindi Jëhorami. Jëhoramit i lindi Uzija. ⁹Uzijës i lindi Jotami. Jotamit i lindi Ahazi. Ahazit i lindi Hizkija. ¹⁰Hizkijës i lindi Mënashëu. Mënashëut i lindi Amoni. Amonit i lindi Joshija. ¹¹Joshijës i lindi Jëkanja me vëllezërit e tij në kohën e shpërnguljes në Babiloni.
¹²Pas shpërnguljes, Jëkanjës i lindi Shëaltieli. Shëaltielit i lindi Zërubaveli. ¹³Zërubavelit i lindi Avihudi. Avihudit i lindi Avneri. Avnerit i lindi Eljakimi. Eljakimit i lindi Azuri. ¹⁴Azurit i lindi Cadoku. Cadokut i lindi Jahini. Jahinit i lindi Elihudi. ¹⁵Elihudit i lindi Elazari. Elazarit i lindi Matani. Matanit i lindi Jakovi. ¹⁶Jakovit i lindi Jozefi, bashkëshorti i Marisë, prej së cilës lindi Jezusi, Mesia.
¹⁷Janë, pra, 14 breza nga Avrahami deri te Davidi, 14 nga Davidi deri te shpërngulja në Babiloni dhe 14 nga shpërngulja deri te Mesia.

♦ Kjo do të jetë gjenealogjia e Josefit, ndërsa gjenealogjia te Luka është ajo e Marisë. Një mundësi tjetër është se Mateu tregon linjën ligjore të Jezusit, ndërsa Luka tregon linjën fizike.

Jezusi – Perëndia me ne

(Lk 2.1-7)

¹⁸Lindja e Jezusit, Mesisë, ndodhi kështu: Maria, nëna e tij, ishte e fejuar me Jozefin. Por, para se të martoheshin, doli se Maria priste një fëmijë të mbarsur me anë të Shpirtit të shenjtë. ¹⁹Jozefi, me të cilin ajo ishte e fejuar, ishte burrë i ndershëm dhe nuk donte ta bënte shembull publik. Kishte ndër mend të ndahej nga ajo fshehtas. ♦²⁰Por, para se të shkonte puna aq larg, iu shfaq në ëndërr një engjëll i Zotit, i cili i tha: «O Jozef, pasardhësi i Davidit, mos ki frikë të marrësh për grua Marinë, sepse fëmija që ajo po pret, u mbar me anë të Shpirtit të Perëndisë. ²¹Ajo do të lindë një djalë: ti do t'ia vësh emrin Jezus (Shpëtimtar), sepse ai do ta shpëtojë popullin e tij nga mëkatet.»
²²Kjo ndodhi që të plotësohej ajo që kishte parashikuar Zoti me anën e profetit (Isaia): ²³*Virgjëresha do të mbarset dhe do të lindë një djalë, i cili do të quhet Imanuel. Ky emër do të thotë: Perëndia me ne.*
²⁴Kur u zgjua, Jozefi iu bind urdhrorit të engjëllit dhe e mori Marinë në shtëpinë e tij. ²⁵Por nuk fjeti me të gjer në lindjen e birit të saj, të cilit ia vuri emrin Jezus.

♦ Mt 19,9; Br 22,13-21

Parashija e mbretërisë së ardhshme mesianike

2 Jezusi lindi në qytetin Bet-Lehem në Jude në kohën e sundimit të mbretit Herod në Jerusalem. Pak pas lindjes së tij, në Jerusalem arritën disa astrologë ♦ nga Lindja ²dhe pyetën: «Ku është foshnja e lindur, mbreti i premtuar i hebrenjve? E pamë yllin e tij duke lindur dhe erdhëm t'i bëjmë nderimet tona.»♦♦

³Kur e dëgjoi këtë, mbreti Herod u turbullua dhe, bashkë me të, mbarë Jerusalemi. ⁴Thirri në mbledhje të gjithë kryepfritërinjtë dhe mësuesit e Ligjit fetar dhe i pyeti: «Ku duhet të lindë Mesia?» ⁵Ata iu përgjigjën: «Në qytetin Bet-Lehem në Jude, sepse kështu ka shkruar profeti (Mikeja): ⁶*Ti, Bet-Lehem, në tokën e Judës, nuk je aspak pa rëndësi ndër qytetet e Judës, sepse nga ti do të vijë ai që do ta udhëheqë popullin tim, Izraelin.*»

⁷Atëherë Herodi i thirri astrologët të vinin fshehtazi tek ai dhe i pyeti hollësisht se kur e kishin parë yllin për herë të parë. ⁸Pastaj i dërgoi ata në Bet-Lehem duke u thënë: «Shkoni dhe informohuni saktësisht për fëmijën, dhe kur ta gjeni, më lajmëroni! Pastaj do të vij vetë për t'i bërë nderimet e mia.»

⁹Pasi morën këto udhëzime, ata u nisën. Ylli që kishin parë në lindjen e tij, u shkoi përpara. U ndal pikërisht mbi vendin ku ndodhej fëmija. ¹⁰Kur e panë yllin, ata u mbushën me gëzim të madh. ¹¹Hynë në shtëpi dhe, kur e gjetën fëmijën bashkë me nënën e tij, Marinë, ranë përmbys dhe i bënë nderimet e tyre. Pastaj shtruan para tij thesarët që i kishin sjellë si dhurata: ar, temjan dhe mirrë. ¹²Në ëndërr Zoti i urdhëroi të mos ktheheshin te Herodi. Kështu morën një rrugë tjetër për t'u kthyer në vendin e tyre.

♦ Fjala "magoi" siç duket, jep të kuptojë që ata kanë ardhur nga Persia.

♦♦ Ylli i përmendur do të jetë drita shumë e shndritshme e shkaktuar nga bashkimi i trefishtë të Jupiterit (ylli mbretëror) dhe Saturnit (ylli i hebrenjve) në yllësinë mbretërore të Regulit. Kështu mund të thuhet se ylli të jetë "shfaqur" me tre raste të njëpasnjëshme.

Ikja për në Egjipt

¹³Natën tjetër, Jozefi pa një ëndërr, në të cilën iu shfaq një engjëll i Zotit që i tha: «Ngrihu, merre fëmijën dhe nënën e tij dhe ik në Egjipt! Rri atje derisa të të them se mund të kthehesh, sepse Herodi do të bëjë çmos për ta vvarë fëmijën.» ¹⁴Pastaj Jozefi u ngrit në mesin e natës, mori fëmijën me nënën e tij dhe u nis për në Egjipt. ¹⁵Atje banuan derisa vdiq Herodi. Kështu u plotësua ajo që kishte parashikuar Zoti me anë të profetit (Hoshea): *Nga Egjipti e thirra Birin tim.*

Vrasja e fëmijëve në Bet-Lehem

¹⁶Kur vuri re se astrologët e kishin mashtruar, Herodin e pushtoi inati. Urdhëroi që të vriteshin të gjithë fëmijët meshkuj nga dy vjeç e poshtë, që ishin në Bet-Lehem dhe në mbarë rrethinën. Kjo i përgjigjej periudhës që Herodi kishte mësuar nga të dhënat e astrologëve. ¹⁷Kështu u realizuan fjalët e profetit Jeremia: ¹⁸*U dëgjua një klithmë në Rama – vaj dhe gjëmë e madhe: Rahela vajton fëmijët e saj. Ajo nuk do të ngushëllohet, sepse ia morën të gjithë.*

Kthimi nga Egjipti në Nazaret

¹⁹Kur vdiq Herodi, Jozefi pa një ëndërr, në të cilën iu shfaq një engjëll i Zotit ²⁰që i tha: «Ngrihu, merre fëmijën dhe nënën e tij dhe kthehu në tokën e Izraelit; sepse të gjithë ata që kishin ndër mend ta vritnin fëmijën, vdiqën.» ²¹Atëherë Jozefi u ngrit, mori fëmijën me nënën e tij dhe u kthye në Izrael.

²²Kur mësoi se në Jude sundonte Arhelau si trashëgimtar i të atit, Herodit, Jozefi nuk guxoi të shkonte atje. Në ëndërr mori udhëzime të mëvonshme dhe pastaj shkoi në Galile. ²³Atje u vendos në qytetin Nazaret (hebr. *Necaret*). Kështu u plotësuan profecia për Jezusin që thoshte se Mesia do të quhej Pinjoll [♦] (hebr. *Necer*).

♦ fjj: nazareas. Lojë fjalësh e mundshme vetëm në hebraisht: Fjala hebraike «*nucri*» mund të përkthehet ose «nazareas» ose «pinjoll im», emërtim mesianik (shih Isaia 11,1).

Predikimi i Gjon Pagëzorit

(Mk 1.1-8; Lk 3.1-18; Gjn 1.19-28)

3 Atëherë Gjon Pagëzori u paraqit në shkretëtirën e Judesë. ²Ai predikonte si vijon: «Ndryshoni, se u afrua mbretëria e Perëndisë!» ♦ ³Për Gjonin profeti Isaia kishte parashikuar kështu: *Në shkretëtirë thërret dikush: Përgatitni rrugën në të cilën po vjen Zoti! Ndërtoni për Perëndinë tonë një udhë të drejtë.*

⁴Gjoni ishte veshur me një rrobë me lesh deveje, me një rrip lëkure në brez. Ushqehet me karkaleca dhe me mjaltë bletësh të egra. ⁵Njerëzit vinin tek ai nga Jerusalemi, nga mbarë Judeja dhe nga krahina e Jordanit, ⁶i pranonin hapur mëkatet e tyre dhe Gjoni i pagëzonte në lumin Jordan.

⁷Tek ai vinin për t'u pagëzuar edhe shumë farisenj dhe saducenj. Atyre u tha: «Pjellë nepërkash, kush ju tha se do t'i ikni gjyqit që po vjen? ⁸Tregoni me anë të veprave tuaja se u penduat me të vërtetë! ⁹Ju është mbushur mendja se asgjë nuk do t'ju ndodhë, pasi Avrahami është stërgjyshi më i lashtë i fisit tuaj. Mos u mashtroni: Perëndia mund të nxjerrë prej këtyre gurëve pasardhës të Avrahamit!

¹⁰Tashmë sëpata godet që në rrënjë, gati për të prerë pëmët. Çdo pemë që nuk jep fryt të mirë, do të pritet dhe do të hidhet në zjarr. ¹¹Unë po ju pagëzoj me ujë në shenjë pendimi. Por ai që po vjen pas meje, ka më shumë pushtet se unë. Unë vetë nuk jam i denjë as për të qenë skllavi i tij më i përlulur! Ai do t'ju pagëzojë me Shpirtin e shenjtë dhe me zjarrin (e gjyqit). ¹²Ai ka në dorë terploten e do të ndajë grurin nga egra. Grurin do ta mbledhë në hambar, kurse bykun do ta djegë në zjarrin që nuk do të shuhet kurrë.»

♦ fjj. mbretëria e qiellit, d.m.th. mbretëria mesianike. Me këtë shprehje kuptohen tri faza :

1). Faza e parë: mbretëria e fshehtë (në zemrat e besimtarëve) ; 2). Faza a dytë : mbretëria e Perëndisë në tokë (me këtë kuptim kryesisht tek ungjijtë) ; 3) faza e fundit : mbretëria e përjetshme (me këtë kuptim kryesisht në letrat e apostujve, por ka edhe aludime për fazën e parë).

Pagëzimi i Jezusit

(Mk 1.9-11; Lk 3.21-22)

¹³Rreth kësaj kohe, Jezusi erdhi nga Galileja në Jordan për t'u pagëzuar nga Gjoni. ¹⁴Gjoni kërkoi t'ia kthente mendjen dhe i tha: «Unë duhet të pagëzohem prej teje, e jo anasjelltas!» ¹⁵Por Jezusi iu përgjigj: «Mos kundërshto! Kështu duhet të veprojmë, që të bëhet gjithçka që kërkon Zoti!» Atëherë Gjoni u bind.

¹⁶Sapo u pagëzua, Jezusi doli nga uji dhe menjëherë u hap qielli, dhe ai (Gjoni) pa Shpirtin e Perëndisë duke zbritur në trajtë pëllumbi mbi Jezusin. ¹⁷Dhe një zë që erdhi nga qielli, tha: «Ky është Biri ♦ im i dashur, i zgjedhuri im. »♦♦

♦ në DhV greke fjala «Pais» mund të përkthehet ose «Bir» ose «Shërbëtor» (shih Isaia 42,1 dhe 44,2). Pagëzimi shënon fillimin e shërbimit të Shërbëtorit të Zotit. ♦♦ d.m.th. Mesia.

Jezusi – shërbëtori i Zotit – vihet në provë

(Mk 1.12-13; Lk 4.1-13)

4 Pas kësaj, Shpirti i Perëndisë e çoi Jezusin në shkretëtirë, ku duhej ta vinte në provë djalli. ²Jezusi, pas dyzet ditësh e netësh agjërimit, kishte uri të madhe. ³Atëherë iu afrua djalli dhe i tha: «Në qoftë se ti je Biri i Perëndisë, atëherë urdhëro që këta gurë të shndërrohen në bukë.» ⁴Por Jezusi iu përgjigj: «Është shkruar (në Shkrimin e shenjtë): *Njeriu nuk jeton vetëm nga buka, por nga çdo fjalë që flet Perëndia.*»

⁵Pastaj djalli e çoi në qytetin e shenjtë, Jerusalem, e vendosi lart në Tempull ⁶dhe i tha: «Në qoftë se je me të vërtetë Biri i Perëndisë, hidhu poshtë: sepse është shkruar: *Zoti do t'i urdhërojë engjëjt e tij, që të të presin në duar që të mos vritesh në ndonjë gur.*» ⁷Jezusi ia ktheu: «Gjithashtu është shkruar: *Mos e provoko Zotin, Perëndinë tënd!*»

⁸Në fund, djalli e çoi mbi një mal shumë të lartë, i tregoi të gjitha mbretëritë e botës me madhështinë dhe pasurinë e tyre ⁹dhe i tha: «Të gjitha këto do të t'i jap ty, në qoftë se bie përmbys para meje dhe më adhuron.» ¹⁰Por Jezusi iu përgjigj: «Largohu, o Satan, sepse është shkruar: *Para Zotit, Perëndisë sate, përmbysu, veç Tij asnjë tjetër nuk duhet të adhurosh.*» ¹¹Pas kësaj, djalli u largua nga Jezusi, dhe engjëjt u afruan për t'u kujdesur për të.

Jezusi fillon veprimtarinë e tij në Galile

(Mk 1.14-15; Lk 4.14-15)

¹²Kur dëgjoi se kishin burgosur Gjonin, Jezusi u tërhoq në Galile. ¹³Nuk qëndroi në Nazaret, por u vendos në Kafarnaum, qytet pranë liqenit Ginosar, në territorin e fisit të Zëvulunit dhe të Naftaliut. ¹⁴Kjo ndodhi që të plotësohej fjala e profetit Isaia: ¹⁵*Tokë e Zëvulunit dhe e Naftaliut, në drejtim të detit ♦ dhe përtej Jordanit, Galile, tokë e paganëve, –* ¹⁶*populli yt që jeton në errësirë, sheh një dritë të madhe. Për të gjithë ata që banojnë në tokën e errët të vdekjes, lindi drita.* ¹⁷Që atëherë Jezusi filloi të predikonte kështu: «Ndryshoni, se u afrua mbretëria e Perëndisë!»

♦ Kafarnaumi ndodhej pikërisht në rrugën drejt detit (lat. *Via maris*) që lidh Egjiptin me Mesopotamin, kështu që ardhja e Krishtit në Kafarnaum përmbush profecinë. Mateu ishte një doganier i cili mblidhte taksat atje.

Jezusi bën nxënës të tij katër peshkatarë

(Mk 1.16-20; Lk 5.1-11)

¹⁸Ndërsa po ecte buzë liqenit të Galilesë, Jezusi pa dy vëllezër, të cilët ishin peshkatarë, Simonin që e quanin edhe Pjetër dhe Andreun. Kur po hidhnin rrjetën në liqen, ¹⁹Jezusi u tha: «Ejani pas meje dhe unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish.» ²⁰Ata menjëherë lanë rrjetat dhe shkuan pas tij.

²¹Duke vazhduar rrugën, Jezusi pa dy vëllezër të tjerë, Jakobin dhe Gjonin. Ata ishin në barkë bashkë me të atin, Zebedeun, duke ndrequr rrjetat. Jezusi i thirri të bëheshin nxënësit e tij; ²²ata menjëherë e lanë barkën dhe të atin, dhe shkuan pas tij.

Jezusi mëson dhe shëron popullin

(Lk 6.17-19)

²³Jezusi shkoi kudo në Galile. Fliste në sinagoga duke shpallur lajmin e mirë për ardhjen e mbretërisë së Perëndisë. Shëroi çdo sëmundje dhe çdo lëngim në popull. ²⁴Nuk kaloi shumë kohë dhe për të filloi të flitej në Sirinë fqinje. I sillnin njerëzit që vuanin nga lëngimet më të ndryshme, si epileptikë, paralizikë dhe të pushtuar nga djalli, dhe ai i shëronte. ²⁵Pas tij shkonte një mori e madhe njerëzish nga Galileja, nga krahina e Lidhjes së Dhjetë Qyteteve, nga Jerusalemi, Judeja dhe nga krahina përtej lumit Jordan.

Manifest i Mesisë

5 Kur pa turmën, Jezusi u ngjit në mal dhe u ul. Nxënësit e tij iu afruan. ²Pastaj i mësoi ata për ato që Zoti kërkon nga populli i tij.

Lumturia e vërtetë

(Lk 6.20-23)

³Jezusi nisi t'u thoshte:

«Lum ♦ ata që varen nga Zoti, ♦♦ sepse atyre u përket mbretëria e Perëndisë. ⁴Lum ata që qajnë, ♦♦♦ sepse Zoti do t'i ngushëllojë. ⁵Lum ata që i besojnë Zotit për sigurinë e tyre, sepse ai do t'u japë për pronë tokën (e premtuar). ⁶Lum ata që digjen që të plotësohet vullneti i Zotit, sepse ai do t'ua shuajë mallin. ⁷Lum ata që janë të mëshirshëm, sepse Zoti do të ketë mëshirë për ta. ⁸Lum ata që qëndrojnë besnikë ndaj Perëndisë, sepse ata do ta shohin atë. ⁹Lum pajtuesit, sepse ata do të quhen bijtë e Perëndisë. ¹⁰Lum ata që përndiqen, sepse kryejnë atë që kërkon Zoti; atyre u përket mbretëria e Perëndisë. ¹¹Lum ju kur njerëzit ju shajnë, dhe ju përndjekin, dhe thonë gjithfarë të zezash kundër jush pa të drejtë, sepse më takoni mua. ¹²Gëzohuni dhe ngazëllohuni, sepse Zoti do t'ju japë shpërblim të madh. Po kështu trajtuan ata edhe profetët para jush.»

♦ fjj. i bekuar, duke gëzuar dashamirësinë e Zotit. ♦♦ e kundërta e vetëmjaftueshmërisë.

♦♦♦ për shkak të apostazisë së kombit izraelit.

Kripa dhe drita për botën

(Mk 9.50; Lk 14.34-35)

¹³«Siç është kripa për ushqimin, ashtu jeni edhe ju për botën. Por në qoftë se kripa e humbet fuqinë e saj, si mund t'i kthehet fuqia? Nuk vlen më për asgjë, kështu që hidhet jashtë dhe njerëzit e shkelin.

¹⁴Ju jeni dritë për botën. Qyteti i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet. ¹⁵As kandili nuk ndizet për ta vënë nën tas. Përkundrazi, vihet mbi shandan për t'u bërë dritë të gjithëve në shtëpi. ¹⁶Po aq duhet të ndritë drita juaj para njerëzve, që ata t'i shohin veprat tuaja të mira e ta lavdërojnë Atin tuaj që është në qiell.»

Jezusi dhe Besëlidhja e vjetër

¹⁷«Mos mendoni se erdha për të anuluar Ligjin e Moisiut dhe udhëzimet e profetëve. ♦ Nuk erdha për t'i anuluar ato, por për t'i bërë realitet. ¹⁸Ju siguroj se derisa të jetë qielli dhe toka, Ligjit nuk do t'i hiqet asnjë shkronjë dhe asnjë presje. ¹⁹Prandaj kush shkel edhe më të voglin nga këto urdhërime dhe i mëson njerëzit të bëjnë ashtu, do të jetë më i vogli në mbretërinë e Perëndisë. Por kush i bindet një urdhërimi të tillë dhe i mëson të tjerët të bëjnë ashtu, do të nderohet në mbretërinë e Perëndisë. ²⁰Prandaj ju siguroj se kurrë nuk do të hyni në mbretërinë e Perëndisë, në qoftë se nuk e plotësoni vullnetin e tij më mirë se mësuësit e Ligjit dhe farisenjtë.»

♦ Jezusi jo vetëm që po sulmon keqinterpretimin rabinik të Ligjit, por edhe zbatimin e gabuar të së drejtës civile në ligjin moral (për shembull, duke legjitimuar hakmarrjen personale, ndërsa ligji civil ka synuar ta kufizojë atë). Ndërsa shumica e legjisacionit të DhV ishte në formën e së drejtës civile, Jezusi mëson parimet e tij morale, pasi kisha nuk është shtet teokratik.

Mësimi për vrasjen

²¹« Ju keni dëgjuar se si rabinët e kanë interpretuar rreshtin: *Mos bëj vrasje*. Kush bën vrasje, duhet të dalë në gjyq. ²²Por unë po ju them: Madje edhe ai që zemërohet me bashkëbesimtarin e tij, duhet të dalë në gjyq. Kush i thotë bashkëbesimtarit të tij: «Budalla!», duhet të dalë në gjyqin më të lartë, kurse kush i thotë: «Të marrtë djalli!», meriton të hidhet në ferr.

²³Në qoftë se shkon në altar, që t'ia kushtosh dhuratën tënde Zotit, dhe atje të kujtohet se bashkëbesimtari yt ka diçka kundër teje, ²⁴atëherë lëre dhuratën tënde aty para altarit dhe shko e pajtohu më parë me bashkëbesimtarin tënd. Pastaj mund t'ia kushtosh dhuratën Zotit.

²⁵Kërko të pajtohesh me huadhënësin tënd sa je ende me të duke shkuar rrugës për në gjyq. Përndryshe, ai do të të dorëzojë te gjykatësi dhe ky tek ekzekutivi i gjyqit për të të futur në burg. ²⁶Unë po të them që nuk do të dalësh që andej para se ta paguash borxhin deri në qindarkën e fundit.»

Mësimi për tradhtinë bashkëshortore

²⁷ Ju keni dëgjuar se si rabinët e kanë interpretuar rreshtin: *Mos bëj tradhti bashkëshortore*. ²⁸Por unë po ju them: Kush e shikon me lakmi gruan (e tjetrit), tashmë ka bërë tradhti bashkëshortore me të në mendjen e tij. ²⁹Në qoftë se syri yt i djathtë të çon në mëkat, nxirre e flake larg teje. Është më mirë për ty të humbasësh njëren prej gjymtyrëve të tua, sesa të të hidhet në ferr i tërë trupi. ³⁰E në qoftë se dora jote e djathtë të çon në mëkat, preje e flake larg teje. Është më mirë për ty të humbasësh njëren prej gjymtyrëve të tua, sesa të të hidhet në ferr i tërë trupi.»

Mësimi për ndarjen martesore

(Mt. 19.9; Mk 10.11-12; Lk 16.18)

³¹« Ju keni dëgjuar se si rabinët e kanë interpretuar rreshtin: *Kush ndan gruan e vet, duhet ta ndajë me dokumentin e ndarjes*. ³²Por unë po ju them: Kush e ndan gruan e vet – edhe pse ajo nuk ka qenë e pabesë ♦ – e shtyn atë në tradhti bashkëshortore: e në qoftë se ndokush martohet me gruan e ndarë, ai bën tradhti bashkëshortore.»

♦ **Martesa nuk mund të anulohet, përveçse me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve. Prandaj, nëse ka ndarje, madje edhe për kurorëshkelje, atëherë asnjëra palë nuk lejohet të rimartohet. Kjo ishte mënyra se si Kisha e hershme e interpretoi këtë pasazh. Një mundësi tjetër është se klauzola përjashtimore u referohet shkallëve të ndaluara të martesës (shih Lv 18) siç mund të ndodhë në Veprat 15,20.**

Mësimi për betimin

³³« Ju keni dëgjuar se si rabinët e kanë interpretuar rreshtin: *Mos e shkel premtimin, por zbato atë që i ke premtuar Zotit me betim*. ³⁴Por unë po ju them: Aspak mos u betoni kur të jepni premtim – mos e merrni qiellin për dëshmitar, sepse është froni i Zotit; ³⁵as tokën, sepse është shtroja e këmbëve të tij; as Jerusalemin, sepse është qyteti i Mesisë. ³⁶As me kokën tuaj nuk duhet të garantoni për diçka, sepse nuk mund të ndikoni që të rritet as edhe një fije floku e bardhë ose e zezë. ³⁷Mos u betoni, por thoni thjesht «po» ose «jo»; çdo fjalë tjetër vjen nga djalli.»

Mësimi për hakmarrjen

(Lk 6.29-30)

³⁸« Ju keni dëgjuar se si rabinët e kanë interpretuar rreshtin: *Sy për sy e dhëmb për dhëmb*. ³⁹Por unë po ju them: Mos u mbroni kundër njeriut të keq. Atij që ju bie me shpullë në faqen e djathtë, kthejini edhe tjetrën. ⁴⁰Atij që ju nxjerr në gjyq për t'ju marrë këmishën, jepini dhe xhakëtën. ⁴¹E në qoftë se një nga trupat pushtuese ju detyron t'i mbani trastën për një kilometër, mbajeni për dy. ⁴²Jepini atij që ju kërkon diçka, dhe mos e kundërshtoni atë që të kërkon hua.»

Mësimi për dashurinë ndaj armiqve

(Lk 6.27-28.32-36)

⁴³« Ju keni dëgjuar se si rabinët e kanë interpretuar rreshtin: *Duaje të afërmin tënd e urreje armikun tënd*. ⁴⁴Por unë po ju them: Duajini armiqtë tuaj, lutjuni Perëndisë për ata që ju përndjekin. ⁴⁵Kështu do të vërtetohet që jeni fëmijët e Atit tuaj qiellor, sepse Ai i trajton njerëzit pa dallim: Ai bën të lindë dielli i tij mbi të këqij e mbi të mirë dhe të bjerë shi mbi të gjithë, qofshin të drejtë a të padrejtë. ⁴⁶E si mund të pritni një shpërblim nga Zoti, në qoftë se doni vetëm ata që ju duan? Edhe kriminelët e duan njëri-tjetrin. ⁴⁷Çfarë veçantie keni, në qoftë se silleni mirë vetëm me bashkëbesimtarët tuaj? A nuk bëjnë ashtu edhe të pafetë? ⁴⁸Jo, ju duhet të silleni mirë me të gjithë njerëzit pa dallim, ashtu siç bën edhe Ati juaj që është në qiell.»

Mësimi për lëmoshën

6 «Shikoni që të mos e tregoni lëmoshën tuaj para njerëzve. Atëherë nuk do të keni aspak shpërblim nga Ati qiellor.

²Prandaj, në qoftë se ndihmoni ndokënd, mos e bëni të madhe, që ta marrë vesh mbarë bota. Mos u

sillni si hipokritët nëpër sinagoga dhe nëpër rrugë. Ata dëshirojnë veçse të nderohen para njerëzve. Unë po ju them: Tashmë ata e kanë marrë shpërblimin e tyre. ³Kur të japësh lëshoshë, bëj kështu pa rënë në sy, që të mos e marrë vesh as miku yt më i ngushtë. ⁴Ati yt, që sheh edhe gjëra më të fshehta, do të të shpërblejë për këtë.»

Mësimi për lutjen

(Lk 11.2-4)

⁵«Kur t'i luteni Zotit, mos bëni si hipokritët. Ata zënë vend me kënaqësi në sinagoga për t'iu lutur Zotit, edhe në qoshe të rrugës, që t'i shohin të gjithë. Ju siguroj se ata tashmë e kanë marrë shpërblimin e tyre. ⁶Kur t'i luteni Zotit, shkoni në dhomën tuaj, mbylleni derën dhe lutjuni Atit tuaj, që është i padukshëm. Ati juaj që sheh se ç'bëni në fshehtësi, do t'ju shpërblejë.

⁷Kur t'i luteni Zotit, mos u zgjatni me fjalë pa kuptim si paganët. Ata mendojnë se do t'u plotësohet lutja, në qoftë se thonë shumë fjalë. ⁸Mos bëni si ata, sepse Ati juaj e di mirë se për çfarë keni nevojë para se t'i luteni. ⁹Prandaj lutjuni kështu: Ati ynë që je në qiell, të nderofshin të gjithë njerëzit! ¹⁰Ardhtë mbretëria jote – u bëftë vullneti yt si në qiell, ashtu edhe në tokë! ¹¹Bukën tonë të përditshme na e jep sot! ¹²Na i fal fajet tona, siç ua falëm ne fajtorëve tanë! ¹³E mos lejo të biem në tundim, por na shpëto nga i Ligu! ¹⁴Në qoftë se ju ua falni njerëzve të tjerë gabimet, atëherë Ati juaj qiellor do t'ju falë juve gabimet; ¹⁵por, në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve të tjerë gabimet, as Ati juaj qiellor nuk do t'ju falë juve gabimet.»

Mësimi për agjërimin

¹⁶«Kur të agjëroni, mos u pezmatoni, si hipokritët. Ata pezmatohen, që të marrin vesh të gjithë se po agjërojnë. Unë po ju them: Ata tashmë e kanë marrë shpërblimin e tyre. ¹⁷Ju, përkundrazi, kur agjëroni, lajeni fytyrën dhe krihu, ¹⁸që të mos e vërejë askush përveç Atit tuaj, që është i padukshëm. Ati yt, që sheh se ç'bëni në fshehtësi, do t'ju shpërblejë për këtë.»

Pasuria e pafund

(Lk 11.34-36; 16.13; 12.22-34)

¹⁹«Mos grumbulloni për vete pasuri këtu mbi tokë, ku e brejnë tenja e ndryshku, ♦ ku futen hajdutët dhe e vjedhin. ²⁰Më mirë mblidhni pasuri për në qiell. Atje nuk mund ta brejë as tenja, as ndryshku; as hajdutët nuk mund të futen për ta vjedhur. ²¹Zemra juaj do të jetë gjithnjë aty ku keni pasurinë tuaj.»

♦ Në atë kohë shumica e pasurisë së njerëzve përbëhej nga rroba të shtrenjta, qilime dhe mallra metalike, në vend të parave.

Gjendja shpirtërore është kryesorja

²²«Syri ia gjen njeriut dritën. Në qoftë se syri është i shëndoshë, ♦ i tërë njeriu është në dritë; ²³në qoftë se syri është i sëmurë, ♦♦ i tërë njeriu është në errësirë. Por kur syri – gjendja juaj shpirtërore – nuk është në rregull, sa e tmerrshme do të jetë ajo errësirë!»

♦ d.m.th. nëse je bujar. ♦♦ d.m.th. nëse je dorështrenguar.

Shqetësimet e përditshme

²⁴«Askush nuk mund t'u shërbëjë dy zotërinjve njëkohësisht. Ose do të dojë njërin, ose do të urrejë tjetrin. Njërit do t'i jetë besnik, kurse tjetrin do ta mashtrorë. Nuk mund t'u shërbeni të dyve njëkohësisht: Perëndisë dhe parasë.

²⁵Prandaj po ju them: Mos u shqetësoni për ushqim dhe pije, as për veshje. Jeta vlen më shumë se ushqimi dhe pija, dhe trupi vlen më shumë se veshja. ²⁶Shikoni zogjtë! Ata as mbjellin, as korrin dhe as grumbullojnë ushqim – por Ati juaj në qiell kujdeset për ta. Megjithatë, ju jeni më të vlefshëm se të gjithë zogjtë! ♦ ²⁷E kush prej jush, megjithë kujdesin e tij, është në gjendje ta zgjatë jetën e vet vetëm për një ditë?

²⁸E përse shqetësoheni se çfarë do të vishni? Shikoni si rriten lulet në fushë! As nuk punojnë, as nuk tjerin. ²⁹Megjithatë po ju them: As vetë Solomoni, me gjithë pasurinë e tij, nuk ishte veshur si njëra prej tyre! ³⁰Meqenëse Perëndia u bën pajën luleve të fushës që sot lulëzojnë dhe nesër hidhen në furrë, ♦♦ vallë a nuk do të kujdeset për ju, besëpakë?!

³¹Mos u shqetësoni! Mos pyetni: Çfarë do të hamë? Çfarë do të pimë? Me çfarë do të vishemi? ³²– Me gjëra të tilla mundohen të pafetë. Ati juaj në qiell e di mirë se ju keni nevojë për të gjitha këto. ³³Shikoni, para së gjithash, që të merreni me punët e mbretërisë së Perëndisë dhe që të bëni atë që kërkon Ai; atëherë Ai do të kujdeset për të gjitha të tjerat.

³⁴Mos e mundoni veten me mendime për të nesërmen; e nesërmja do të kujdeset vetë për veten. Secilës ditë i mjafton pikëllimi i vet.»

♦ Argumentimi *a fortiori* (nga pohimi më i vogël në pohimin më të madh). Shembujt e tjera për këtë ndërtim janë si vijon: Mt 7,11 : 10,25 : 12,12 ; Lk 11,13 ; 12,24.28 ; Rm 5,9-10.15.17; 11,12.24; 1 Kor 12,22; Fil 2,12; Fl 16; Heb 9,14; 10,29; 12,25. ♦♦ Bari u hodh në furrat e balta për t'i ngrohur aq nxehtë për të pjekur bukën.

Mos kritikoni

(Lk 6.37-38, 41-42)

7 «Mos i kritikoni të tjerët, që të mos ju kritikojë Zoti; ²sepse kritika juaj do t'ju kthehet dhe do të mateni me të njëjtën masë që matni të tjerët. ³Pse shikoni halën në syrin e bashkëbesimtarit dhe nuk shihni më parë trarin në syrin tuaj? ⁴Si guxoni t'i thoni bashkëbesimtarit tuaj: «Eja këtu. Ta nxjerr unë halën nga syri», kurse ju keni tra në syrin tuaj? ⁵Hipokrit, nxirrni më parë trarin nga syri juaj, e pastaj do të shihni mjaft qartë që ta nxirrni halën nga syri i bashkëbesimtarit tuaj.

⁶Mos u jepni qenve për ushqim gjëra të shenjta! Mos ua hidhni derrave margaritarët tuaj. Ata vetëm sa do t'i shkelin, e pastaj do të hidhen kundër jush për t'ju sulmuar.»

Lutuni, kërkoni, trokitni

(Lk 11.9-13)

⁷«Lutuni dhe do t'ju jepet! Kërkoni dhe do të gjeni! Trokitni dhe do t'ju hapen dyert! ⁸Kush lutet, i jepet; kush kërkon, gjen; kush troket, i hapen dyert. ⁹Kush prej jush do t'i jepte fëmijës një gur, kur ai ju lutet për bukë? ¹⁰Ose i jep gjarpër, kur ai ju lutet për peshk? ¹¹Sado të këqij të jeni, ju dini t'u bëni mirë fëmijëve tuaj dhe t'u jepni atyre. Dhe aq më tepër Ati juaj që është në qiell, do t'u japë gjëra të mira atyre që ia kërkojnë këto.»

Rregulla e artë dhe dera e ngushtë

(Lk 13.24)

¹²«Trajtojini njerëzit ashtu siç doni që t'ju trajtojnë edhe ju – kjo është gjithçka që kërkon Perëndia në Ligj dhe në librat e Profetëve.

¹³Hyni nga dera e ngushtë, sepse dera që të çon në rrënim, është e gjerë, dhe rruga për atje është e lehtë. Shumë veta udhëtojnë nëpër të. ¹⁴Por dera që të çon në jetë, është e ngushtë dhe rruga për atje është e vështirë. Pak njerëz kalojnë nëpër të.»

Paralajmërimi për profetët e rremë

(Lk 6.43-44)

¹⁵«Ruhuni nga profetët e rremë! Ata duken, vërtet, si dele që i takojnë kopesë, por në të vërtetë janë ujë që kanë dalë për gjah. ¹⁶Ju mund t'i njihni nga ajo që bëjnë. Nga ferrat nuk mund të vilet rrush; as nga murrizat nuk mund të vilen fiq. ¹⁷Një pemë e shëndoshë jep fruta të mira, kurse një pemë e keqe fruta të këqija. ¹⁸Dhe anasjelltas, një pemë e mirë nuk mund të japë fruta të këqija, as edhe një pemë e keqe fruta të mira. ¹⁹Çdo pemë që nuk jep fruta të mira, do të pritet dhe do të hidhet në zjarr. ²⁰Kështu, pra, do t'i njihni profetët e rremë nga frytet e tyre.»

Paralajmërimi për vetëmashtrim

(Lk 13.25-27)

²¹Çdonjëri që më thotë vazhdimisht «O Zot», nuk është e thënë se do të hyjë patjetër në mbretërinë e Perëndisë, por vetëm ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiell. ²²Ditën e gjyqit shumë veta do të më thonë: «O Zot, o Zot, a nuk profetizua në emrin tënd, a nuk i dëbua shpirtrat e këqij, a nuk bëmë shumë mrekulli?» ²³E megjithatë, unë do të nxjerr këtë vendim: «Kurrë nuk ju kam njohur! Ju ishit në anën e djallit; largohuni prej meje!»

Mbarimi i predikimit në mal

(Lk 6.47-49)

²⁴Kush i dëgjon fjalët e mia dhe i vë në jetë ato, i ngjan, pra, njeriut që mendon mirë çdo gjë që bën; dhe, për këtë e ndërtoi shtëpinë e tij mbi themelin shkëmbor. ²⁵Kur ra rrebesh, vërshuan përrenjtë; stuhia u tërbua dhe tundi shtëpinë; por ajo nuk u rrëzua, sepse ishte ndërtuar mbi shkëmb. ²⁶Përkundrazi, kush nuk i dëgjon fjalët e mia e nuk vepron sipas tyre, në fund do të mbetet si budallai që e ndërtoi shtëpinë e vet mbi rërë. ²⁷Kur ra rrebesh, vërshuan përrenjtë; stuhia u tërbua, shtëpia e tij u tund, u rrëzua dhe humbja e tij ishte e madhe.»

²⁸Kur Jezusi mbaroi predikimin, të gjithë mbetën të habitur nga mësimi i tij, ²⁹sepse fliste si një njeri me fuqi të plotë nga Zoti – krejt ndryshe nga mësuesit e tyre të Ligjit.

Shërimi i të lebrosurit

(Mk 1.40-45; Lk 5.12-16)

8 Kur Jezusi zbriti nga mali, i shkonte pas një turmë e madhe. ²Atëherë një i lebrosur iu afrua, ra përmbys para tij dhe i tha: «O Zot, në qoftë se ti do, mund të më pastrosh.» ³Jezusi shtriu dorën, e preku dhe i tha: «Dua; pastrohul!» Dhe menjëherë lebra iu pastrua. ⁴Jezusi e urdhëroi: «Kujdes që të mos i tregosh kujt për këtë! Shko te prifti dhe le të të kontrollojë ai. Pastaj kushtoji (Zotit) flijimin që ka caktuar Moisiu. Kjo do t'u vlejë atyre për dëshmi (se je shëruar me të vërtetë).»

Kapiteni nga Kafarnaumi

(Lk 7.1-10)

⁵Kur Jezusi hyri në Kafarnaum, iu afrua një kapiten, johebre, dhe iu lut për ndihmë: ⁶«O Zot, – tha ai, – shërbëtori im është shtrirë në shtëpi i paralizuar dhe po vuan shumë.» ⁷Jezusi i tha: «Do të vij e ta shëroj.» ⁸Kapiteni iu përgjigj: «O Zot, e di që nuk mund të shpresoj se ti do të hysh në shtëpinë time. Por mjafton që të japësh urdhër dhe shërbëtori im do të shërohet. ⁹Edhe unë jam nën komandën më të lartë dhe kam nën komandën time ushtarët. Njërit i them: «Shko!» dhe ai shkon, dhe një tjetri: «Eja!» dhe ai vjen, dhe shërbëtorit tim i them: «Bëje këtë!» dhe ai e bën.» ¹⁰Jezusi, kur e dëgjoi këtë, u habit dhe u tha njerëzve që po i shkonin pas: «Ju siguroj se nuk e kam gjetur ende një besim kaq të madh tek askush tjetër në Izrael! ¹¹Megjithatë po ju them: Edhe shumë (johebrenj) do të vijnë nga lindja e nga perëndimi dhe do të ulen në tryezë me Avrahamin, Izakun dhe Jakovin në mbretërinë e Perëndisë, ¹²por njerëzit që deri tani kanë të drejtën e trashëgimisë, do të hidhen në errësirë. Atje do të vajtojnë dhe do të kërcëllin dhëmbët.» ¹³Pastaj Jezusi i tha kapitenit: «Shko e le të bëhet ashtu siç besove!» Pikërisht në atë çast shërbëtori i tij u shërua.

Shërimet e ndryshme

(Mk 1.29-34; Lk 4.38-41)

¹⁴Jezusi shkoi në shtëpinë e Pjetrit dhe gjeti atje vjehrrën e Pjetrit të shtrirë e me ethe të forta. ¹⁵Jezusi i preku dorën: ethet e lëshuan menjëherë dhe ajo u ngrit dhe i përgatiti darkën.

¹⁶Kur u err, Jezusi i sollën shumë njerëz të pushtuar nga djalli. Ai i dëboi shpirtrat e këqij me pushtetin e fjalës së tij dhe i shëroi të gjithë të sëmurët. ¹⁷Kështu u plotësua profecia e profetit Isaia: *Ai mori mbi vete lëngatat dhe sëmundjet tona.*

Dishepuj pa kompromis

(Lk 9.57-62)

¹⁸Kur e pa turmën që po e rrethonte, Jezusi u dha urdhër nxënësve të tij të kalonin në anën tjetër të liqenit. ¹⁹Para se të niseshin, iu afrua një mësues i Ligjit dhe i tha: «Unë jam gati të vij pas teje kudo që të shkosh!» ²⁰Jezusi iu përgjigj: «Dhelprat kanë strofkat e veta dhe zogjtë çerdhet e veta, kurse Biri i njeriut ♦ nuk ka ku ta mbështetë kokën për të pushuar.»

²¹Një nxënës tjetër i tha Jezusit: «O Zot, më parë më lejo të varros atin tim.» ²²Jezusi iu përgjigj: «Eja pas meje! Lëri të vdekurit të varrosin të vetët!»

♦ Do të jetë aludim për Shërbëtorin pesimtar te Isaia 53. Nuk ka gjasa të nënkuptojë Mesia, pasi ky është një titull që Jezusi evitoi hapur.

Dishepujt në stuhi

(Mk 4.35-41; Lk 8.22-25)

²³Jezusi hipi në barkë dhe nxënësit i shkuan pas. ²⁴Kur ishin në liqen, u ngrit një stuhi e madhe: valët u grumbulluan dhe ata ishin në rrezik të fundoseshin. Por Jezusi flinte. ²⁵Nxënësit e zgjuan dhe i thanë: «Shpëtona, o Zot, se po fundosemi.» ²⁶Jezusi u tha: «Pse kini kaq frikë, besëpakë?» Pastaj u ngrit në këmbë dhe qortoi erërat e valët. E u bë qetësi e madhe. ²⁷Njerëzit u habitën dhe i thanë njëri-tjetrit: «Kush është ky që i binden edhe erërat e valët?»

Dy njerëzit nga Gadara të pushtuar nga djajtë

(Mk 5.1-20; Lk 8.26-39)

²⁸Në bregun tjetër të liqenit, Jezusi u ndodh në krahinë e gadarasve. Atje i erdhën me vrap dy njerëz që dolën nga varret. Ata ishin të pushtuar nga djajtë dhe aq të rrezikshëm, saqë askush nuk guxonte të kalonte asaj rruge. ²⁹Menjëherë bëritën: «Ç'do prej nesh, o Biri i Perëndisë? A do të na torturosh para kohe?»

³⁰Jo larg tyre po kulloste një tufë e madhe derrash. ³¹Shpirtrat e këqij brenda të dy njerëzve iu lutën Jezusit: «Kur të na dëbosh, na lejo të paktën të hyjmë në atë tufë derrash.» ³²«Atëherë shkon!» – u tha Jezusi. Shpirtrat dolën nga të dy njerëzit dhe hynë në tufë. Pastaj mbarë tufa u turr drejt greminës dhe ra në liqen, ku u mbyt në ujë.

³³Rojtarët e derrave ua mbathën këmbëve dhe treguan në qytet atë që kishin përjetuar dhe që kishte ndodhur me shërimin e të dy njerëzve të pushtuar nga djajtë. ³⁴Të gjithë banorët e qytetit i dolën përpara Jezusit për ta parë. Pastaj iu lutën me këmbëngulje që të largohej nga krahina e tyre.

Shërimi i paralitikut

(Mk 2.1-12; Lk 5.17-26)

9 Jezusi hipi përsëri në barkë, kaloi liqenin dhe shkoi në qytetin e vet. ²Atje disa njerëz i sollën me vig një paralitik. Kur pa se kishin kaq besim tek ai, Jezusi i tha paralitikut: «Mos ki frikë! Të janë falur mëkatet!» ³Disa mësues të Ligjit thanë me vete: «Ky po shan Zotin!» ⁴Jezusi e dinte se ç'po mendonin dhe u tha: «Përse keni kaq mendime të këqija? ⁵Çfarë është më lehtë të thuhet: «Të janë falur mëkatet» apo «Ngrihu dhe ec!»? ♦ ⁶Por dëshiroj që ta shihni se Biri i njeriut ka pushtet për të falur mëkatet mbi tokë.»

Prandaj i tha paralitikut: «Ngrihu, merre vigun tënd dhe shko në shtëpi!» ⁷Njeriu u ngrit në këmbë dhe shkoi në shtëpi. ⁸Kur panë këtë, njerëzit i kaploi një frikë e madhe dhe lavdëruan Perëndinë që u kishte dhënë njerëzve pushtet kaq të madh.

♦ argument nga rasti më i madh në rastin më të vogël. Meqë Jezusi mund të bëjë më të vështirën, nënkuptohet që Ai mund të falë edhe mëkatet – d.m.th. t'i shpëtojë njerëzit nga pasojat e mëkateve të tyre për t'u dhënë jetën e përjetshme.

Thirrja e Mateut

(Mk 2.13-17; Lk 5.27-32)

⁹Jezusi shkoi më tutje dhe pa të ulur në doganë një njeri që quhej Mate. Jezusi i tha: «Eja pas meje!» Mateu u ngrit në këmbë dhe i shkoi pas. ♦

¹⁰Më vonë Jezusi ishte i ftuar tek ai. Për të ngrënë bashkë me Jezusin dhe nxënësit e tij, erdhën shumë tagrambledhës dhe njerëz të tjerë me nam të keq. ¹¹Disa farisenj e panë këtë dhe i pyetën nxënësit e Jezusit: «Si ka mundësi që mësuesi juaj të ulet në të njëjtën tryezë me tagrambledhës dhe me një llum të tillë të shoqërisë?» ¹²Jezusi e dëgjoi këtë dhe iu përgjigj: «Mjeku nuk u duhet të shëndoshëve, por të sëmurëve. ¹³Ç'nënkuptoni kur Zoti thotë: *Unë nuk kërkoj (kryesisht) nga ju që të më bëni fljime kafshësh, por që të jeni të mëshirshëm.* Unë nuk erdha të ftoj (në mbretërinë e Zotit) ata që mbahen për të drejtë, por ata që pranojnë se janë mëkatarë.»

♦ Kjo ishte shumë e pazakontë, sepse dishepujt zakonisht zgjidhnin rabinin e tyre dhe jo anasjelltas (shih Gjn 15,16).

Çështja e agjërimit

(Mk 2.18-22; Lk 5.33-39)

¹⁴Pas kësaj dishepujt e Gjon Pagëzorit shkuan te Jezusi dhe e pyetën: «Si ndodh që ne dhe farisenjtë agjërojmë rregullisht, e nxënësit e tu jo?» ¹⁵Jezusi iu përgjigj: «Me siguri nuk pritni që dasmorët të mbajnë zi derisa të jetë me ta dhëndri? Do të vijë mjaft shpejt koha kur do t'u rrëmbehet dhëndri. Atëherë edhe ata do të agjërojnë (që ai të kthehet).

¹⁶Askush nuk e arnon rrobën e vjetër me një copë stofi të ri, sepse stofi i ri tkurret dhe grisja bëhet më e madhe. ¹⁷As vera e re nuk hidhet në kacekë të vjetër; përndryshe ata shpohen, vera derdhet dhe kacekët prishen. Jo, vera e re duhet hedhur në kacekë të rinj, e kështu ruhen të dy.»

Vajza kthehet në jetë

(Mk 5.21-43; Lk 8.40-56)

¹⁸Ndërsa Jezusi po u shpjegonte këtë, tek ai shkoi një anëtar i administratës lokale, ra përmbys para tij dhe tha: «Sapo më vdiq vajza. Eja, vëre dorën mbi të dhe ajo do të kthehet në jetë.» ¹⁹Jezusi u ngrit dhe shkoi pas njeriut. Nxënësit e tij e shoqëruan.

²⁰Gjatë rrugës Jezusit iu afrua nga prapa një grua që vuante nga menorragjia që dymbëdhjetë vjet të shkuara. Ajo preku një tufë fijesh të rrobës së tij. ²¹Tha me vete: «Në qoftë se i prek vetëm rrobën, do të shërohem.» ²²Jezusi u kthye, e shikoi dhe i tha: «Mos ki frikë! Besimi yt (tek unë) të shpëtoi.» Dhe aty për aty gruaja u shërua.

²³Jezusi hyri në shtëpi ku po vajtonin vajzën e vdekur. Kur pa të gjithë mysafirët që vajtonin, si dhe ata që u binin fyejve për varrim, ²⁴u tha: «Dilni jashtë! Vajza nuk ka vdekur, por po fle.» Por ata e përqeshën.

²⁵Megjithatë, Jezusi i detyroi ata të dilnin përjashta, hyri në dhomën ku ishte e shtrirë vajza dhe e mori për dore. Ajo u ngrit! ²⁶Lajmi i kësaj mrekullie u përhap në mbarë krahinën.

Shërimi i dy të verbërve

²⁷Kur Jezusi u nis që andej, pas tij shkuan dy të verbër duke bërtitur: «Ki mëshirë për ne, Biri i Davidit!»

²⁸Kur hyri në shtëpi, të verbrit i shkuan pas dhe ai i pyeti: «A besoni se mund t'ju ndihmoj?» Ata iu përgjigjën: «Po, Zotëri!» ²⁹Atëherë ai u preku sytë e u tha: «U bëftë sipas besimit tuaj.» ³⁰Dhe atyre iu kthye drita e syve. Jezusi i urdhëroi: «Kini kujdes që të mos e dijë askush!» ³¹Por ata u nisën dhe treguan për Jezusin në mbarë krahinën.

Shërimi i memecit

³²Pasi u larguan ata, Jezusit i sollën një njeri që ishte memec, ngaqë një shpirt i keq e kishte nën fuqinë e tij. ³³Sapo dëboi djallin, njeriu filloi të fliste, dhe të gjithë thirrën të habitur: «Në Izrael nuk ka ndodhur kurrë një gjë e tillë!» ³⁴Por farisenjtë thoshin: «Ky i dëbon djajtë me fuqinë e kryetarit të djajve.»

Jezusi i dërgon nxënësit e tij nëpër popullin e Izraelit

³⁵Jezusi kaloi nëpër të gjitha qytetet dhe fshatrat e atij vendi. Dha mësim në sinagoga dhe predikoi lajmin e mirë për ardhjen e mbretërisë së Perëndisë dhe shëroi të gjitha sëmundjet e lëngatat. ³⁶Kur pa turmën e njerëzve, iu ngjall një keqardhje për ta, sepse ishin të hutuar dhe të frikësuar si delet pa bari. ³⁷Prandaj u tha nxënësve të tij: «Të korrrat janë të mëdha, por punëtorë ka pak. ³⁸Lutjuni, pra, Zotit, të cilit i takojnë të korrrat, që të dërgojë punëtorë për t'i mbledhur ato.»

Dymbëdhjetë apostujt

(Mk 3.13-19; Lk 6.12-16)

10 Jezusi mblodhi tek ai dymbëdhjetë nxënësit e tij dhe u dha fuqi të plotë, që të dëbonin shpirtat e këqij dhe të shëronin çdo sëmundje dhe lëngatë. ²Këtu janë emrat e këtyre dymbëdhjetë apostujve: i pari Simoni, që quhet ndryshe edhe Pjetër; pastaj vijnë Andreu, vëllai i Simonit; Jakobi dhe i vëllai

Gjoni, të bijtë e Zebedeut; ³Filipi dhe (Natanael) Bar-Tolmai; Toma dhe Mateu, tagrambledhësi; Jakobi, biri i Halfait, dhe Tadaï; ⁴Simoni, ish-anëtar i partisë së zelotëve, dhe Juda nga Karioti, ai që më vonë tradhtoi Jezusin. ♦

♦ Disa nga dishepujt e Jezusit ishin simpatizantë zelotë, posaçërisht Juda, i cili e tradhtoi Jezusin sepse ishte i zhgënyer që ky nuk kishte organizuar një kryengritje kundër romakëve pas hyrjes së tij mesianike në Jeruzalem. Për këtë arsye ai bëri vetëvrasje, kur vuri re se i kishte bërë llogaritë gabim. Turma u kthye kundër Jezusit sepse ishte gjithashtu e zhgënyer për shkak se Jezusi nuk doli si Mesi politik. Dy dishepujt që i takoi Jezusi në rrugë për në Emaus ishin gjithashtu të këtij mendimi.

Detyra e apostujve

(Mk 6.7-13; Lk 9.1-6)

⁵Këta të dymbëdhjetë Jezusi i dërgoi me detyrën që vijon: "Mos shkoni në vendet ku banojnë johebrenjtë, as mos hyni në qytetet e Samarisë, ⁶por shkoni te kopeja e humbur, te populli i Izraelit, ⁷dhe thuajini: «U afrua mbretëria e Perëndisë!» ⁸Shëroni të sëmurët, ringjallni të vdekurit, pastroni të lebrosurit dhe dëboni shpirtrat e këqij! Gjithçka e morët falas, prandaj përcilleni falas. ⁹Mos merrni të holla: as të arta, as të argjendta e as prej bakri! ¹⁰Mos merrni trastë me ushqim, as këmishë për të ndërruar, as këpucë, as shkop për udhëtim! Kush punon, ka të drejtë për ushqimin e vet.

¹¹Kur të hyni në qytet ose në fshat, kërkoni njeriun që pranon lajmin tuaj dhe për këtë është i denjë t'ju pranojë në shtëpinë e tij. Rrini tek ai derisa të shkoni më tutje. ¹²Kur të hyni në një shtëpi, u uroni paqen të gjithë anëtarëve të saj. ¹³Në qoftë se ata janë të denjë, urimi juaj do të plotësohet. Përndryshe urimi nuk do të ketë vlerë. ¹⁴Atje ku nuk ju pranojnë dhe nuk duan t'ju dëgjojnë, dilni nga shtëpia ose nga qyteti dhe shkundni edhe pluhurin nga këmbët tuaja. ¹⁵Ju siguroj se Ditën e Gjyqit do ta kenë pasur më të lehtë banorët e Sodomit dhe të Gomorës sesa ai qytet." ♦

♦ d.m.th. Kur të bjerë dënimi, Zoti do të ketë treguar më shumë mëshirë për Sodomën, sesa për atë qytet. Banorët do të masakrohen nga romakët.

Përndjekja e ardhshme

(Mk 13.9-13; Lk 21.12-17)

¹⁶«Unë po ju dërgoj si dele mes ujqish! Jini të mençur si gjarpërinjtë dhe pa dinakëri si pëllumbat!

¹⁷Ruhuni nga njerëzit! Ata do t'ju hedhin në gjyq të sinagogës dhe do t'ju fshikullojnë. ¹⁸Për shkakun tim do t'ju hedhin para sundimtarëve dhe mbretërve, e kështu mund të dëshmoni për mua para tyre dhe para paganëve. ¹⁹Kur t'ju nxjerrin para gjyqit, mos u shqetësoni se çfarë dhe si do të flitni. Do t'ju vijnë fjalët që duhet të thoni. ²⁰Nuk do flitni ju, por Shpirti i Atit tuaj do të flasë nëpërmjet jush.

²¹Vëllai do t'ia dorëzojë vëllanë vdekjes dhe babai fëmijët; edhe fëmijët do të ngrihen kundër prindërve të tyre dhe do të urdhërojnë që të vriten. ²²Të gjithë do t'ju urrejnë ngaqë jeni nxënësit e mi. Por ai që do të qëndrojë i patundur deri në fund, do të shpëtojë. ²³Kur t'ju përndjekin në njërin qytet, ikni në tjetrin! Ju siguroj se nuk do t'i keni përshkuar qytetet e Izraelit para se të vijë Biri i njeriut. ♦

²⁴Asnjë nxënësi nuk është më i madh se mësuesi i tij dhe asnjë skllav nuk është më i madh se i zoti.

²⁵Nxënësi duhet të jetë i kënaqur kur trajtohet si mësuesi i tij, dhe skllavi kur trajtohet si i zoti. Në qoftë se zotin e shtëpisë e quajnë Satan, aq më tepër do të thuhet për shtëpiakët e tij!»

♦ Tregimi në lidhje me përndjekjet hedh nga shekulli i parë në shtrëngimin e madh të kohës së fundit. Çifutët do të jenë të parët për të dëgjuar Ungjillin dhe të fundit për ta dëgjuar atë.

Nga kush duhet pasur frikë

(Lk 12.2-7)

²⁶«Mos kini frikë nga asnjë njeri! Ajo që është ende e fshehur, duhet të dalë në dritë, kurse ajo që nuk dihet ende nga askush, duhet të zbulohet. ²⁷Atë që po ju them sy për sy, përcilleni haptas, e atë që po ju them fshehtas, predikojeni në të gjithë botën. ²⁸Mos kini frikë nga ata që vrasin trupin, por që nuk mund të vrasin shpirtin. Kini frikë nga Zoti, i cili mund të dërgojë në rrënim të përjetshëm edhe shpirtin, edhe trupin. ²⁹A nuk shiten dy trumcakë për një qindarkë? E megjithatë, asnjë trumcak nuk bie në tokë pa lejen e Atit tuaj. ³⁰Po ju? Çdo qime e kokës suaj është e numëruar. ³¹Prandaj mos kini frikë: ju jeni më të vlefshëm se shumë trumcakë para syve të Zotit.

³²Cilindo që më mbron para njerëzve, do ta mbroj para Atit tim qiellor (ditën e gjyqit). ³³Por cilindo që më mohon para njerëzve, do ta mohoj para Atit tim qiellor (ditën e gjyqit).»

Jo paqen, por shpatën

(Lk 12.51-53; 14.26-27)

³⁴«Mos mendoni se erdha që të sjell paqen në botë. Nuk erdha për të sjellë paqen, por përçarjen. ³⁵Erdha të

ndaj birin nga i ati, bijën nga e ëma, nusen nga vjehrra. ³⁶Më të afërmit do të jenë armiq me njëri-tjetrin. ³⁷Kush e do të atin e të ëmën më shumë se mua, nuk është i denjë të jetë nxënësi im. ³⁸Kush nuk e merr kryqin e vet e nuk vjen pas meje, nuk është i denjë të jetë nxënësi im. ³⁹Kush do ta ruajë jetën e tij, do ta humbasë atë. Kush do ta japë jetën e tij për shkakun tim, do ta rifitojë atë.»

Dinjiteti i nxënësit

(Mk 9.41)

⁴⁰«Kush ju pranon ju, më pranon mua; e kush më pranon mua, pranon Atë që më dërgoi.

⁴¹Kush pranon profetin ngaqë është profet, do të marrë shpërblimin që i takon profetit; kush pranon mësuesin e kishës ngaqë është mësues i kishës, do të marrë shpërblimin që i takon mësuesit të kishës.

⁴²Kush i jep më të voglit prej nxënësve të mi qoftë edhe një gotë ujë të freskët vetëm ngaqë është nxënësi im, ju siguroj se ai do të marrë shpërblimin e tij.»

1 1 Kur Jezusi ua dha këto udhëzime nxënësve të tij, shkoi më tutje për të dhënë mësim në qytetet e vendit për vullnetin e Zotit dhe për të predikuar lajmin e mirë.

Kush është Gjon Pagëzori?

(Lk 7.18-35)

²Kur dëgjoi për veprat e Jezusit, Gjon Pagëzori dërgoi disa nxënës të tij. ³«A je ti Mesia, Ai që duhet të vijë, – e pyetën, – apo duhet të presim një tjetër?» ⁴Jezusi iu përgjigj: «Kthehuni te Gjoni dhe tregojini ato që po dëgjoni e shihni: ⁵Të verbrit po shohin, paralitikutë po ecin, të lebrurit po pastrohen, shurdhët po dëgjojnë, të vdekurit po ringjallen dhe të varfërve po u predikohet lajmi i mirë. ⁶Lum ai që nuk e braktis besimin tek unë.»

⁷Pasi nxënësit u larguan, Jezusi nisi t'i fliste turmës për Gjoni: «Kur shkua te Gjoni në shkretëtirë, ç'menduat se ishte ai? Njeri që mund të manipulohet? ⁸Çfarë dolët të shikonit? Një oborrar? Njerëz të tillë rrinë në pallate! ⁹Po pse dolët atëherë? Të shikonit një profet? Ja ku po ju them: Keni parë më tepër se një profet, ¹⁰sepse Gjoni është ai për të cilin në Shkrimin e shenjtë thuhet: *Unë po e dërgoj lajmëtarin tim para teje (thotë Zoti), që të të hapë rrugën.*

¹¹Ju siguroj se Gjoni është më i rëndësishëm se kushdo që ka jetuar ndonjëherë. E megjithatë, më i vogli në mbretërinë e Perëndisë është më i madh se ai. ¹²Kur u paraqit Gjon Pagëzori, Zoti filloi të themelonte mbretërinë e tij, dhe deri tani ajo dhunohet dhe njerëzit e dhunshëm kërkojnë ta shuajnë. ¹³Ligji i Moisiut dhe të gjithë profetët deri te Gjoni, kanë shpallur ardhjen e mbretërisë së Perëndisë, ¹⁴e Gjoni është, në njëfarë kuptimi, «Elija», ardhja e të cilit është profetizuar. ¹⁵Kush mund të dëgjojë, të dëgjojë mirë.

¹⁶Me kë ta krahasoj këtë brez? Ai u ngjan djemve që qëndrojnë në sheshe. Një grup e qorton tjetrin ¹⁷duke thirrur: «Ne bëmë muzikë dasme e ju nuk vallëzuat; bëmë gjëmë e ju nuk vajtuat!» ¹⁸Gjoni po agjëronte e njerëzit thanë: «Është i çmendur!» ¹⁹Erdhi Biri i njeriut; ai ha e pi, e megjithatë, thonë: «Ja, grykësi e pijaneci! Shoku i tagrambledhësve dhe i mëkatarëve!» Por urtësia ♦ (e Zotit) vërtetohet nga pasojat e veta.»

♦ d.m.th. mënyra se si Zoti i shpëton njerëzit.

Kush nuk do të dëgjojë...

(Lk 10.13-15)

²⁰Pastaj Jezusi filloi të qortonte qytetet ku kishte bërë shumicën e mrekullive, e megjithatë, njerëzit nuk i lanë mëkatet e tyre për t'u kthyer te Zoti. ²¹«I mjeri ti, Korazin, e mjera ti, Bet-Caidë! Sikur të ishin bërë në Tir dhe në Sidon të gjitha mrekullitë që u bënë ndër ju, njerëzit e atjeshëm do ta kishin ndërruar prej kohësh mënyrën e jetesës, duke u veshur me thes dhe me hi të hedhur mbi kokë (si shenjë pendimi). ²²Ju siguroj se Tiri e Sidoni do ta kenë më të lehtë se ju Ditën e Gjyqit! ²³E ti, o Kafarnaum, a mendon se do të ngrihesh deri në qiell? Ti do të plandosesh në botën e të vdekurve! Sikur të ishin bërë në Sodom mrekullitë që u bënë në ty, ky qytet do të qëndronte edhe sot. ²⁴Ju siguroj se Sodomi do ta ketë pasur më lehtë se ju Ditën e Gjyqit!»

Vetëm Jezusi, Mesia, mund të na njohë me Atin

(Lk 10.21-22)

²⁵Pastaj Jezusi thirri: «O Atë, Zoti i qiellit e i tokës, unë të lavdëroj që u tregove të paditurve atë që fshehe nga të urtët dhe të diturit. ²⁶Po, o Atë, kështu të pëlqeu ty! ²⁷Ati më ka dhënë fuqi të plotë. Vetëm Ati është në marrëdhënie atërore me Birin, dhe vetëm Biri e ata që ai dëshiron t'i njohë me Atin, janë në marrëdhënie birnore me të.

²⁸Ju mundoheni me rregullat që ju kanë vënë mësuesit e Ligjit. Ejani më mirë tek unë: Unë do t'ju heq barrën. ♦ ²⁹Unë nuk do t'ju mundoj dhe nuk do të shikoj asnjeri me përbuzje. Vihuni nën drejtimin tim dhe mësoni nga unë: Atëherë do të gjeni paqen e vërtetë. ³⁰Ajo që ju caktoj unë, ju bën mirë, dhe ajo që ju jap të mbani, nuk është aspak barrë.»

♦ I kthyeri në judaizam merr përsipër t'u përmbahet 345 urdhërimeve!

Jezusi dhe e shtuna

(Mk 2.23-28; Lk 6.1-5)

12 Pas një kohe, një të shtunë, ♦ Jezusi po kalonte nëpër fushat e mbjella. Nxënësit e tij kishin uri; prandaj këputnin kallinj dhe u hanin kokrrat. ²Kur e panë këtë, farisenjtë i thanë Jezusit: «E sheh se ç'po bëjnë nxënësit e tu? Sipas Ligjit, kjo ndalohej të bëhet të shtunën.»

³Jezusi u përgjigj: «Vallë a nuk keni lexuar se ç'bëri Davidi dhe shoqëruesit e tij kur ishin të uritur? ⁴Hynë në shtëpinë e Perëndisë dhe hëngrën së bashku bukët e kushtuara (Perëndisë), megjithëse kjo u ishte e ndaluar, sepse vetëm priftërinjtë kishin të drejtë t'i hanin. ⁵Apo nuk keni lexuar në Ligj që madje edhe priftërinjtë punojnë të shtunën në Tempull? Kështu i prishin rregullat e së shtunës; e megjithatë, për këtë nuk u llogaritet faj. ⁶E unë po ju them: Këtu është diçka më e madhe se Tempulli! ⁷Ta kishit kuptuar se ç'do të thotë fjala: *Nuk kërkohet (kryesisht) nga ju që të më bëni flijime kafshësh, por që të jeni të mëshirshëm*; atëherë nuk do t'i kishit dënuar këta njerëz që nuk po bëjnë faj. ⁸Përveç kësaj, unë, Biri i njeriut, kam të drejtë të caktoj se çfarë mund të bëhet të shtunën e çfarë jo. » ♦♦

♦ fffj. shabat: ditë pushimi fetar e hebrenjve në të cilën çdo lloj pune ndalohej.

♦♦ fffj. Biri i njeriut është me të vërtetë zoti i së shtunës!

Shërimi të shtunën

(Mk 3.1-6; Lk 6.6-11)

⁹Jezusi shkoi më tutje dhe hyri në sinagogën e tyre. ¹⁰Atje ishte një njeri që e kishte dorën të paralizuar. Farisenjtë kërkonin ta zinin ngushtë Jezusin, prandaj e pyetën: «A është e lejueshme që ndokush të shërojë ditën e shtunë?» ¹¹Jezusi u përgjigj: «A ka midis jush ndonjë njeri që, po t'i bjerë të shtunën në gropë delja e vetme që ka, të mos e nxjerrë? ¹²E megjithatë, njeriu është më i vlefshëm se delja! Prandaj është e lejueshme që njeriu të ndihmohet të shtunën!» ¹³Pastaj i tha njeriut: «Shtrije dorën!» Njeriu e shtriu dorën dhe dora iu bë e shëndoshë si tjetra. ¹⁴Pas kësaj farisenjtë dolën jashtë dhe vendosën që ta vritnin Jezusin.

Jezusi – Shërbëtori i zgjedhur i Zotit

¹⁵Kur e dëgjoi këtë, Jezusi u largua nga ai vend. Pas tij shkuan shumë njerëz. I shëroi të gjithë të sëmurët, ¹⁶por ua ndaloi me këmbëngulje t'i tregonin ndokujt për këtë. ¹⁷Me këtë u plotësua ajo që kishte parathënë profeti Isaia: *«Ja shërbëtori im, të cilin e forcoj – atë që kam zgjedhur, me të cilin jam i kënaqur. E kam mbushur me shpirtin tim, dhe ai do t'i sjellë drejtësi çdo kombi. ¹⁹Ai nuk do të thërrasë, as do ta ngrejë zërin dhe as do të mbajë fjalime me zë të lartë në rrugë. ²⁰Ai nuk do ta thyejë kallamin e përkulur e as do ta shuajë kandilin që regëtin. Ai do t'u sjellë drejtësi të qëndrueshme të gjithëve. Atë nuk do ta lëshojë as shpresa e as zemra; ai do të vendosë drejtësi në tokë. ²¹Tek ai do t'i varin shpresat të gjitha kombet.*

Nga vjen pushteti i Jezusit?

(Mk 3.20-30; Lk 11.14-23)

²²Pastaj i sollën Jezusit një njeri që ishte i verbër dhe memec, pasi e kishte mbërthyer një shpirt i keq. Jezusi e shëroi, kështu që ai mund të fliste dhe të shihte. ²³Mbarë populli mbeti i habitur e thoshte: «A nuk është ky Biri i parashikuar i Davidit?» ²⁴Por kur i dëgjuan këto, farisenjtë kundërshtuan: «Ky nuk i dëbon djajtë vetë, por kryetari i djajve ♦ i jep pushtet për këtë.»

²⁵Jezusi e dinte se ç'po mendonin dhe u tha: «Çdo shtet, sundimtarët e të cilit grinden mes tyre, do të rrënohet dhe asnjë qytet ose familje ku ka grindje, nuk do të mund të qëndrojë. ²⁶Në qoftë se Satani dëbon vetveten, atëherë ka përçarje në vetvete. Pra, si mund të qëndrojë sundimi i tij? ²⁷E në qoftë se unë i dëboj shpirtrat e këqij sepse jam në lidhje me Satanin, kush ua jep njerëzve tuaj pushtetin për t'i dëbuar shpirtrat e këqij – Satani? ♦♦ Dishepujt tuaj dëshmojnë se ju nuk keni të drejtë. ²⁸Por në qoftë se unë i dëboj shpirtrat e këqij me anë të Shpirtit të Perëndisë, atëherë është e qartë se Perëndia tashmë ka filluar të themelojë mbretërinë e tij mes jush.

²⁹Kush dëshiron të futet me dhunë në shtëpinë e një njeriu të fortë për ta plaçkitur, duhet së pari ta lidhë atë; vetëm atëherë mund ta plaçkitë shtëpinë e tij. ³⁰Kush nuk është në anën time, është kundër meje, dhe kush nuk më ndihmon të mbledh, shpërndan. ³¹Ju siguroj se çdo mëkat dhe sharje tjetër mund t'u falet njerëzve, por kush shan Shpirtin e Zotit, nuk do të gjejë asnjë ndjesë. ³²Kush shan Birin e njeriut, ♦♦♦ kjo mund t'i falet. Por kush shan Shpirtin e shenjtë në këtë epokë ose në epokën që po vjen, kjo nuk do t'i falet aspak.

♦ fffj. Baal-zevuv (d.m.th. zoti i mizave = i djajve). ♦♦ Jezusi argumenton se në qoftë se dëbimi i djajve varet nga lidhja me Satanin, në emër të të cilit dëbojnë farisenjtë djajtë? ♦♦♦ d.m.th. në kohën e misionit të tij mbi tokë, kur dukej si njeri

i zakonshëm. Qysh nga ringjallja puna ndryshon.

Ata mund të njihen nga fjalët e tyre

(Lk 6.43-45)

³³Të hamendësojmë se pema është e shëndoshë, kështu që prej saj mund të priten fruta të mira. Në qoftë se është e prishur, atëherë nuk priten gjë tjetër veçse fruta të këqija. Pema njihet nga frutat. ³⁴Pjellë nepërkash! Si mund të flitni mirë, kur jeni të këqij? Ç'ka zemra, e nxjerr goja! ³⁵Njeriu i mirë nxjerr gjëra të mira, sepse zemra e tij është e mirë. Njeriu i keq nxjerr vetëm të këqija, sepse është në thelb i keq. ³⁶Ju siguroj se Ditën e Gjyqit njerëzit do të japin llogari për çdo fjalë të kotë që kanë folur! ³⁷Në bazë të fjalëve të tua do të marrësh pafajësinë ose do të dënohesh.»

Jezusit i kërkohet një provë

(Mk 8.11-12; Lk 11.29-32)

³⁸Disa mësues të Ligjit dhe farisenj i thanë Jezusit: «Kërkojmë nga ti një provë të padisku-tueshme që je i dërguar nga Zoti.» ³⁹Jezusi u përgjigj: »Sa të mbrapshtë janë këta njerëz! Nuk duan t'ia dinë për Zotin, e megjithatë, duan të shohin një provë prej tij. E vetmja provë që do të marrin, i përgjigjet asaj që i ndodhi profetit Jona.

⁴⁰Ashtu siç ishte Jona në barkun e peshkut të madh për tri ditë e tri net, ashtu edhe unë, Biri i njeriut, do të jem në «barkun» e tokës për tri ditë e tri net.

⁴¹Ditën e Gjyqit, banorët e Ninaves do të ngrihen (si dëshmitarë) dhe do të paditin njerëzit e sotëm, sepse kur i paralajmëroi Jona, e ndryshuan mënyrën e jetesës. Pikërisht këtu është dikush më i madh se Jona!

⁴²Mbretëresha e Shebës do të ngrihet (si dëshmitare) Ditën e Gjyqit dhe do të paditë njerëzit e sotëm, sepse erdhi nga skaji i botës për të dëgjuar mësimet e urta të Solomonit, dhe pikërisht këtu është dikush më i madh se Solomoni!

Reziku i boshllëkut shpirtëror

(Lk 11.24-26)

⁴³Kur shpirti i keq largohet nga njeriu, brend nëpër vende të shkreta duke kërkuar vendbanim, por nuk gjen. ⁴⁴Pastaj thotë me vete: «Do të kthehem në shtëpinë time të mëparshme!» Kthehet dhe e gjen shtëpinë të zbrazët, të pastër dhe të rregulluar. ⁴⁵Pastaj shkon, merr me vete shtatë shpirtra më të këqij se veten, dhe ata hyjnë e vendosen atje. Kështu, gjendja e fundit e këtij njeriu bëhet më e keqe se e para. Kështu do t'i ndodhë edhe këtij brezi të prishur.»

Familja e vërtetë e Jezusit

(Mk 3.31-35; Lk 8.19-21)

⁴⁶Ndërsa Jezusi po i predikonte popullit, erdhën nëna dhe vëllezërit e tij. Ata po qëndronin para shtëpisë dhe kërkonin të flitnin me të. ⁴⁷Dikush prej turmës i tha: «Nëna jote dhe vëllezërit e tu po presin jashtë; dëshirojnë të flasin me ty.» ⁴⁸Jezusi iu përgjigj: «Kush është nëna ime dhe vëllezërit e mi?» ⁴⁹Pastaj i tregoi me gisht nxënësit e tij dhe tha: «Ja, nëna ime dhe vëllezërit e mi! ⁵⁰Pikërisht ai që kryen vullnetin e Atit tim në qiell, është vëllai im, motra ime dhe nëna ime.»

Jezusi flet me shëmbëlltyra

(Mk 4.1-9; Lk 8.4-8)

13 Atë ditë Jezusi doli nga shtëpia, shkoi në breg të liqenit dhe u ul. ²U mblodhën aq shumë njerëz, sa që Jezusi iu desh të hipte në barkë. Turma qëndronte në breg ³dhe ai u mësoi shumë gjëra në formë shëmbëlltyrash.

Mbjellësi besimplotë

Ai tha: «Doli bujku në fushë për të mbjellë. ⁴Duke hedhur farën, i ranë në rrugë disa kokrra. Erdhën zogjtë dhe i hëngrën. ⁵Disa i ranë në zallishtë ku kishte pak dhe. Ato mbinë shpejt; ⁶por kur u ngrit dielli lart në qiell, i thau bimët e reja, sepse nuk kishin mjaft dhe. ⁷Disa të tjera ranë në ferra, dhe ferrat i mbytën dhe ua zunë frymën. ⁸Disa të tjera ranë në tokë të mirë dhe ato dhanë fryt; disa 100-fish, disa 60-fish, disa 30-fish.» ⁹E Jezusi shtoi: «Kush mund të dëgjojë, të dëgjojë mirë.»

Përse përdor shëmbëlltyra Jezusi?

(Mk 4.10-12; Lk 8.9-10)

¹⁰Nxënësit shkuan te Jezusi dhe e pyetën: «Përse përdor shëmbëlltyra kur u flet njerëzve?» ¹¹Jezusi u përgjigj: «Zoti ju zgjodhi ju (e jo ata) t'i njihni fshehtësitë ♦ e mbretërisë së Perëndisë. ¹²Atij që ka shumë, do t'i jepet edhe më, kështu që do të ketë më shumë sesa i duhet. Atij që ka pak, do t'i merret edhe ajo pakicë që ka. ¹³Për këtë arsye unë përdor shëmbëlltyra kur flas me ta, sepse shikojnë, por nuk dallojnë asgjë; dëgjojnë, po nuk kuptojnë asgjë. ¹⁴Tek ata plotësohet kjo profeci e profetit Isaia: *Ky popull do të*

dëgjojë mirë, por nuk do të kuptojë asgjë; do të shikojë me vëmendje, por nuk do të dallojë asgjë! ¹⁵ Sepse ky popull është i pandreqshëm në shpirtin e tij. Zuri veshët dhe mbylli sytë që të mos shohë, të mos dëgjojë e të mos kuptojë – thotë Zoti. – Ndryshe ai do të kthehej tek unë, dhe unë do ta shëroja. ¹⁶ Ju, përkundrazi, mund të gëzoheni, sepse sytë tuaj shohin dhe veshët tuaj dëgjojnë.

¹⁷ Ju siguroj se shumë profetë dhe njerëz të përshtirshëm dëshironin të shihnin atë që po shihni ju tani, por nuk e panë. Ata donin të dëgjonin atë që po dëgjoni ju tani, por nuk e dëgjuan.

♦ Trajta e veçantë e mbretërisë së Perëndisë në kohën midis ardhjes së Mesisë dhe kthimit të tij ishte një mësim i ri, i panjohur deri atëherë për judaizmin.

Shpjegimi i shëmbëlltyrës për mbjellësin

(Mk 4.13-20; Lk 8.11-15)

¹⁸ Tani dëgjoni ç'do të thotë shëmbëlltyra për mbjellësin: ¹⁹ Ka njerëz që e dëgjojnë lajmin për mbretërinë; por ata nuk e kuptojnë. Pastaj vjen armiku i Zotit dhe nxjerr atë që është mbjellë në zemrën e tyre. Atyre u ndodh ashtu si me kokrrën që bie në rrugë. ²⁰ Me të tjerët është si me kokrrën që bie në zallishte. Ata e dëgjojnë lajmin e mirë dhe menjëherë e pranojnë me gëzim; ²¹ por nuk mund të lëshojnë rrënjë në vetvete, sepse këta njerëz janë të lëkundshëm. Kur vjen ndonjë vështirësi ose përndjekje për shkak të këtij lajmi, ata menjëherë heqin dorë nga feja. ²² Me të tjerët është si me kokrrën që bie në ferra. Ata vërtet e dëgjojnë lajmin e mirë, por lajmi nuk vepron, sepse këta njerëz humbasin në kujdeset e tepruara të kësaj epoke dhe mashtrohen nga pasuria. Kështu, këta ia zënë frymën lajmit. ²³ Me të tjerët është si me kokrrën që bie në tokën e mirë. Ata e dëgjojnë dhe e kuptojnë lajmin e mirë dhe japin fryt; disa 100-fish, disa 60-fish dhe disa 30-fish.»

Egjra në grurë

²⁴ Pastaj Jezusi u tregoi një shëmbëlltyrë tjetër: "Zhvillimi i mbretërisë së Perëndisë i ngjan veprimtarisë së njeriut që kishte mbjellë farë të shëndoshë në arën e tij. ²⁵ Natën, kur njerëzit po flinin, erdhi armiku i tij, mbolli egjër nëpër grurë dhe iku. ²⁶ Kur u rrit gruri dhe lëshoi kallinj, doli edhe egjra. ²⁷ Pastaj punëtorët erdhën te çifligari dhe e pyetën: «Zotëri, a nuk mbolle farë të mirë në arën tënde? Nga doli, atëherë, egjra?» ♦ ²⁸ Çifligari u përgjigj: «Sigurisht, e ka bërë ndokush që dëshiron të më dëmtojë.» Punëtorët pyetën: «A të shkojmë e ta nxjerrim egjërën?» ²⁹ «Jo, – u tha çifligtari, – se do të nxirrni edhe grurin bashkë me të. ³⁰ Lërinin të rriten bashkë deri në të korrat. Në kohën e të korrave do t'u them korrësve: mblidhni më parë egjërën dhe lidhni në duaj për ta djegur, ndërsa grurin futeni në hambarin tim.»"

♦ Egjra duket si gruri në fazat e hershme të rritjes.

Sinapi dhe tharmi

(Mk 4.30-32; Lk 13.18-19; Dan 4.10-12)

³¹ Jezusi tregoi një shëmbëlltyrë tjetër: «Zhvillimi i mbretërisë së Perëndisë i ngjan sinapit që mbjell ndokush në arën e tij. ³² Nuk ka farë më të vogël; por ajo që del prej saj, bëhet më e madhe se të gjitha barishtet e tjera. Zhvillohet si një pemë e vërtetë: në degët e tij zogjtë mund të ndërtojnë fole. ♦

³³ Ose ndodh si me tharmin: një grua e përzier me 25 kilogramë miell derisa të zihet i gjithë brumi.»

♦ Ata do të jenë kombet e botës që shtrehohen nga mbretëria e Perëndisë.

Përse përdor shëmbëlltyra Jezusi?

(Mk 4.33-34)

³⁴ Të gjitha këto Jezusi ia tha popullit me shëmbëlltyra dhe nuk shpjegonte asgjë pa to. ³⁵ Kështu u plotësua ajo që kishte parathënë Zoti me anë të Davidit: *Do të flas me shëmbëlltyra dhe do të tregoj gjëra të fshehura që nga krijimi i botës.*

Shpjegimi i shëmbëlltyrës për egjërën

³⁶ Pastaj Jezusi e nisi turmën dhe hyri në shtëpi. Nxënësit e tij iu afruan dhe e pyetën: «Na e shpjego pak shëmbëlltyrën e egjërës në arë.»

³⁷ Ai u përgjigj: «Njeriu që mbjell farën e mirë, është Biri i njeriut. ³⁸ Ara është bota ♦ dhe fara e mirë janë njerëzit që i nënshtrohen sundimit të Zotit. Egjra janë ata që janë në anën e armikut të Zotit. ³⁹ Armiku që e mbolli egjërën, është djalli. Të korrat do të bëhen në mbarimin e kësaj epoke, dhe korrësit janë engjëjt.

⁴⁰ Ashtu siç mblidhet egjra dhe hidhet në zjarr, po ashtu do të ndodhë edhe në mbarimin e kësaj epoke:

⁴¹ Biri i njeriut do t'i dërgojë engjëjt e tij, të cilët do të nxjerrin nga mbretëria e tij të gjithë ata që nuk e dëgjuan Zotin, ashtu edhe ata që nxitën të tjerët që të mos e dëgjojnë Zotin. ⁴² Engjëjt do t'i hedhin ata në furrë të ndezur, ku do të qajnë e do të kërcëlljnë dhëmbët. ⁴³ Pastaj të gjithë ata që e dëgjuan Zotin, do të ndritin si dielli në mbretërinë e Atit të tyre. ♦♦

Pra, kush mund të dëgjojë, të dëgjojë mirë.

♦ “Bota” do të shënojë hebrejtë të shpërndarë nëpër botë. ♦♦ Bëhet fjalë për mbretërinë e Izraelit, prej së cilës do të shfarosen hebrejtë e jorilindur (shih Mt 15,13).

Thesari i fshehur dhe margaritarët

⁴⁴Me mbretërinë e Perëndisë ndodh si me thesarin e fshehur në arë. Një njeri e gjen dhe menjëherë e fsheh përsëri. Pastaj shet plot gëzim çdo gjë që ka, dhe e blen atë tokë.

⁴⁵Kush e kupton ftesën e Zotit, vepron si tregtari që kërkon margaritarë të çmueshëm. ⁴⁶Kur gjen një margaritar me vlerë shumë të madhe, shet gjithçka që ka dhe e blen atë.

Shëmbëlltyra për rrjetën

⁴⁷Me përfundimin e mbretërisë së Perëndisë do të ndodhë si me rrjetën që hidhet në det ku mbledhet çdo lloj peshku. ⁴⁸Kur mbushet rrjeta, peshkatarët e tërheqin atë në breg, ulen dhe i mbledhin peshqit e mirë në shporta, kurse të papërdorshmit i flakin. ⁴⁹Kështu do të ndodhë edhe në mbarimin e kësaj epoke: do të dalin engjëjt e do të ndajnë ata që nuk e dëgjuan Zotin nga ata që kryen vullnetin e tij. ⁵⁰Kështu, të pabindurit do të hidhen në furrë të ndezur, ku do të ketë të qara dhe kërcëllitje dhëmbësh. ♦

♦ Kjo shëmbëlltyrë ka të bëjë, gjithashtu, me mbretërinë e Izraelit. Kombi hebreu do të gjykohet me kthimin e Jezusit. Njerëzit e tjerë do të gjykojnë pas mijëvjeçarit.

Mësuesit e rinj të Ligjit

⁵¹«A i kuptuat të gjitha këto?» – i pyeti Jezusi nxënësit e tij. «Po!» – u përgjigjën ata. ⁵²Ai u tha: «Kështu, pra, qysh tani do të ketë mësues të rinj të Ligjit – ata që kanë mësuar kuptimin e vërtetë të mbretërisë së Perëndisë. Një mësues i tillë mund të krahasohet me një zot të shtëpisë që mund të nxjerrë nga qilari i tij gjëra të reja dhe të vjetra.»

Jezusi në Nazaret

(Mk 6.1-6; Lk 4.16-30)

⁵³Pasi i tregoi këto shëmbëlltyra, Jezusi u largua nga ajo krahinë ⁵⁴dhe shkoi në qytetin ku ishte rritur. Atje dha mësim në sinagogë dhe të gjithë ata që e dëgjuan, mbetën të habitur. «Nga i erdhi këtij kjo urtësi dhe kjo fuqi mrekullish?» – pyetnin njëri-tjetrin. ⁵⁵ – «A nuk është ai biri i zdruckthëtarit? Po a nuk i quhet nëna Mari, e vëllezërit Jakob, Jozef, Simon e Judë? ⁵⁶A nuk janë midis nesh motrat e tij? Atëherë nga i erdhën këtij të gjitha këto?» ⁵⁷Prandaj ata nuk donin t’ia dinin për të. Por Jezusi u tha: «Profeti nderohet kudo me përjashtim të vendlindjes dhe familjes së tij!» ⁵⁸Pasi nuk pranuan t’i besonin, ai nuk bëri shumë mrekulli atje.

Vdekja e Gjon Pagëzorit

14 Në atë kohë Herod Antipa, sundimtar i asaj krahine, dëgjoji se ç’flitej për Jezusin. ²«Ky është Gjon Pagëzori! – u tha njerëzve të tij. – U kthye në jetë! Ja, përse ka pushtet të bëjë mrekulli.»

³Herodi e kishte arrestuar Gjonin dhe e kishte futur të lidhur në burg. Shkaku për këtë ishte ky: Herodi i kishte marrë Filipit, ♦ vëllait të vet, gruan me emrin Herodia dhe ishte martuar me të. ⁴Gjoni e kishte qortuar Herodin për këtë: «Nuk të lejohet martesë me të!» ⁵Për këtë arsye Herodi donte ta vriste, por kishte frikë nga populli, i cili e quante Gjonin profet.

⁶Në ditëlindjen e Herodit, e bija e Herodisë vallëzoi para të ftuarve. Aq shumë i pëlqeu Herodit, ⁷saqë iu betua: «Do të të jap çdo gjë që të kërkosh.» ⁸Ajo, e nxitur nga nëna e saj, iu lut: «Sillmë në pjatë kokën e Gjon Pagëzorit!» ⁹Për këtë Herodi u trishtua, por meqë ishte betuar para të gjithë të ftuarve, urdhëroi që të zbatohet kërkesa e vajzës. ¹⁰Dërgoi xhelatin në burg, ♦♦ i cili ia preu kokën Gjonit ¹¹dhe e solli në pjatë, ia dorëzoi vajzës dhe ajo ia dha nënës së saj.

¹²Nxënësit e Gjonit morën trupin e tij dhe e varrosën. Pastaj shkuan te Jezusi dhe i treguan se ç’kishte ndodhur.

♦ Jo Philip tetrarku, por një tjetër nga bijtë e Herodit të Madh. Veprimi i Herod Agrippës fyeu babanë e gruas së tij të divorcuar, mbretin Aretas, i cili më pas e mposhti Herodin në betejë, të cilin shumë e konsideruan si hakmarrje të Perëndisë kundër Herodit. ♦ Në kështjellën e Machaerus, në lindje të Detit të Vdekur.

Jezusi ushqen mrekullisht pesë mijë veta

(Mk 6.30-44; Lk 9.10-17; Gjn 6.1-14)

¹³Jezusi, kur dëgjoji për këtë, u largua që andej dhe shkoi me barkë në një vend të pabanuar – në vetmi. Por populli e mori vesh se ku ishte dhe i shkoi pas, duke ardhur nga të gjitha vendet dhe duke udhëtuar nëpër tokë. ¹⁴Kur doli Jezusi nga barka, pa një turmë të madhe njerëzish para tij. Atij i erdhi keq për ta

dhe shëroi të sëmuret.

¹⁵Në mbrëmje nxënësit iu afruan Jezusit dhe i thanë: «Po bëhet vonë dhe ky vend është i shkretë. Jepu leje njerëzve të shkojnë në fshatra për të blerë ushqim.» ¹⁶Jezusi u përgjigj: «Nuk është nevoja të shkojnë; jepuni ju të hanë!» ¹⁷Ata iu përgjigjën: «Kemi vetëm pesë bukë dhe dy peshq.» ¹⁸Jezusi tha: «M'i sillni këtu!» ¹⁹Ai i dha urdhër popullit të ulej në bar. Pastaj mori pesë bukë e dy peshqit, e drejtoi shikimin e tij në qiell dhe tha lutjen e falënderimit. I ndau bukët copë-copë, ua dha nxënësve dhe ata ia ndanë turmës. ²⁰Të gjithë hëngrën dhe u ngopën. Nxënësit madje mbushën dymbëdhjetë shporta nga ato që tepruan. ²¹Aty kishin ngrënë rreth pesë mijë burra, pa përfshirë gratë e fëmijët.

Jezusi ecën mbi ujë

(Mk 6.45-52; Gjn 6.15-21)

²²⁻²³Menjëherë pas kësaj, Jezusi dërgoi përpara nxënësit e tij me barkë në bregun tjetër. E lejoi popullin që të shkonte në shtëpi dhe pastaj hipi në mal për t'u lutur. Në mbrëmje ndodhej atje krejtësisht vetëm. ²⁴Ndërkohë, nxënësit ishin larg në liqen; barka e tyre përplasej nga valët, pasi era po frynte në drejtimin e kundërt. ²⁵Nga mëngjesi, Jezusi shkoi tek ata duke ecur mbi liqen. ²⁶Kur e panë duke ecur kështu, u trembën. Mendonin se ishte fantazmë dhe bërtitën nga frika. ²⁷Por Jezusi u tha menjëherë: «Mos u trembni! Jam unë, mos kini frikë!» ²⁸Pjetri tha: «O Zot, në qoftë se je me të vërtetë ti, më urdhëro të vij tek ti mbi ujë!» ²⁹«Eja!» – i tha Jezusi. Pjetri zbriti nga barka e po ecte nëpër ujë për të shkuar te Jezusi. ³⁰Por kur pa dallgët e mëdha, u frikësua. Filloi të humbiste në ujë dhe bërtiti: «Më shpëto, o Zot!» ³¹Jezusi shtriu menjëherë dorën, e kapi Pjetrin dhe i tha: «Besëpak, përse dyshove?» ³²Pastaj hipën të dy në barkë dhe era pushoi. ³³Ata që ishin në barkë, ranë përmbys para Jezusit e thanë: «Me të vërtetë ti je Biri i Perëndisë!»

Jezusi shëron në Ginosar

(Mk 6.53-56)

³⁴Pasi kaluan liqenin dhe arritën pranë Ginosarit, ³⁵banorët e vendit e dalluan Jezusin dhe e përhapën lajmin për ardhjen e tij në të gjithë krahinën. Pastaj i sollën të gjithë të sëmuret. ³⁶Ata iu lutën që t'i lejonte të preknin vetëm tufën e fijeve të rrobës së tij. Të gjithë ata që e prekën, u shëruan.

Traditat e të parëve

(Mk 7.1-13)

15 Pastaj disa farisenj dhe mësues të Ligjit nga Jerusalemi iu afruan Jezusit dhe e pyetën: ²«Përse nuk i ndjekin nxënësit e tu mësimet që na kanë lënë të parët? Përse nuk e bëjnë ritin e larjes së duarve para se të hanë bukë?» ³Jezusi iu përgjigj: ⁴«Përse e shkëlmi urdhërimin e Perëndisë për hir të mësimet tuaj? ♦ «Perëndia ka thënë: *Ndero atin dhe nënën tënde; dhe Kush mallkon babë e nënë, të dënohet me vdekje.* ⁵Por ju, nga ana tjetër, thoni: Kush i thotë babait e nënës: «Ajo që duhej t'ju jepja juve, i është kushtuar Perëndisë», ⁶nuk ka më nevojë t'i nderojë prindërit me anë të ndihmës financiare. Kështu e anuloni urdhërimin e Perëndisë me anë të mësimet tuaja. ⁷Ju hipokritë, profeti Isaia ka folur me të drejtë për ju: ⁸*Ky popull më nderon vetëm me fjalë (thotë Zoti), por zemra e tij është larg meje. ⁹E gjithë shërbesa e tyre fetare është e kotë, sepse japin mësim veçse urdhërime të shpikura nga njerëzit.»*

♦ Farisenjtë, në vend që t'i bindeshin ligjit, gjithmonë po shqyrtonin mënyrat për të shmangur ligjin dhe për të bërë përjashtime. Kjo quhet kazuistikë (shih p.sh. Mt 23,16-17)

Kush mund e kush nuk mund të hyjë në praninë e Zotit

(Mk 7.14-23)

¹⁰Pastaj Jezusi e ftoi popullin t'i afrohej e i tha: «Dëgjoni mirë e kuptoni! ¹¹Njeriun nuk e ndot ajo që i hyn në gojë, por ajo që i del nga goja.»

¹²Pas kësaj iu afruan nxënësit dhe i thanë: «A e di se farisenjtë u zemëruan nga fjalët e tua?» ¹³Jezusi u përgjigj: «Ajo që nuk ka mbjellë vetë Ati im në qiell, do të shkulet. ¹⁴Hiquni prej tyre! Atyre u pëlqen të prijnë të verbrit, ndërsa ata janë vetë të verbër! Kur i verbri i prin të verbrit, bien të dy në gropë.»

¹⁵Pastaj Pjetri i tha: «Na e shpjego ç'do të thuash kur flet për papastërtinë (rituale)!» ¹⁶«Përsëri nuk po merrni vesh?» – iu përgjigj Jezusi. ¹⁷«Po a nuk e kuptoni se i gjithë ushqimi që hyn në gojë, shkon në stomak dhe pastaj del jashtë, ¹⁸kurse ajo që del nga goja, del nga zemra dhe kjo e bën njeriun të papastër. ¹⁹Dhe pikërisht nga zemra dalin qëllime të këqija: vrasje, tradhti bashkëshortore, imoralitet, vjedhje, shpifje dhe fyerje. ²⁰Këto e bëjnë njeriun të papastër, jo të ngrënit pa bërë ritin e larjes së duarve.»

Besimi i gruas johebreje

(Mk 7.24-30)

²¹Jezusi u largua nga vendi dhe shkoi në krahinat e Tirit e të Sidonit. ²²Një grua kënanase që banonte aty, iu afrua dhe filloi të thërriste: «O Zot, Biri i Davidit, ♦ ki mëshirë për mua. Shpirti i keq ma mundon

vajzën shumë.» ²³Por Jezusi nuk iu përgjigj fare. Më në fund nxënësit ngulën këmbë: «Shko që ta heqësh qafe; po bërtet pas nesh!» ²⁴Por Jezusi tha: «Zoti më dërgoi vetëm te kopeja e humbur, te populli i Izraelit.» ²⁵Pastaj gruaja ra përmbys para Jezusit e tha: «Më ndihmo, o Zot!» ²⁶Jezusi iu përgjigj: «Nuk është e drejtë që t'ua marrësh bukën fëmijëve e t'ua hedhësh qenve shtëpiakë!» ²⁷«Po, o Zot, – shtoi ajo, – se edhe qentë shtëpiakë hanë thërrimet që bien nga tryeza e zotërinjve të tyre.» ²⁸Jezusi iu përgjigj: «O gruaja, ti ke besim të madh! Le të bëhet ashtu siç dëshiron!» E bija u shërua përnjëherë.

♦ Ajo i drejtohet atij si Mesisë hebre.

Shërime të ndryshme në popull

²⁹Jezusi u largua që andej dhe shkoi në liqenin e Galilesë. U ngjit në një mal dhe u ul. ³⁰Iu afrua një turmë e madhe që sillte me vete shumë paralizikë, të verbër, memecë dhe shumë të tjerë. I ulën para tij dhe ai i shëroi. ³¹Njerëzit u habitën kur panë se si memecët flitnin, paralizikët ecnin andej-këtej, të verbrit shihnin dhe sakatët e tjerë u shëruan. Ata i dhanë lavdi Perëndisë së Izraelit.

Jezusi ushqen katër mijë johebrenjtë

(Mk 8.1-10)

³²Pas kësaj Jezusi mblodhi nxënësit e tij dhe u tha: «Më vjen keq për këtë popull. Ka tri ditë që rri me mua dhe nuk ka ç'të hajë. Nuk dua t'i nis të uritur, që të mos u bjerë të fikët rrugës.» ³³Por nxënësit thanë: «Ku mund të gjejmë aq bukë sa ta ngopim gjithë këtë popull në këtë krahinë të pabanuar?» ³⁴«Sa bukë keni?» – pyeti Jezusi dhe ata u përgjigjën: «Shtatë bukë e disa peshq të vegjël.» ³⁵Pastaj i dha urdhër popullit të ulejt në tokë. ³⁶Mori të shtatë bukët dhe peshqit, tha lutjen e falënderimit, i ndau, ua dha nxënësve të tij, dhe ata ia shpërndanë popullit. ³⁷Të gjithë hëngrën derisa u ngopën, e me copat që tepruan, mbushën plot shtatë kofinë. ³⁸Ata që hëngrën, ishin katër mijë burra, përveç grave e fëmijëve. ³⁹Pastaj Jezusi i dërgoi në shtëpi, ndërsa vetë hipi në barkë dhe shkoi në krahinën e Magadanit.

Farisenjtë kërkojnë një provë

(Mk 8.11-13; Lk 12.54-56)

16 Disa farisenj dhe saducenj iu afruan Jezusit për ta vënë në provë. Kërkonin nga ai një shenjë nga qielli si dëshmi që ishte me të vërtetë i dërguar nga Zoti. ²Por Jezusi u përgjigj: «Kur bie mbrëmja, thoni: «Do të kemi mot të mirë, sepse u skuq qielli.» ³Kurse në agim: «Sot do të kemi shi, sepse qielli është i kuq dhe i vrenjtur.» Kështu, ju dini t'i vlerësoni dukuritë e qiellit e të arrini në përfundim për motin. Përse, pra, nuk dini ta kuptoni se ç'paralajmërojnë ngjarjet e kësaj kohe? ⁴Sa të prishur janë njerëzit e kësaj kohe! Nuk duan t'ia dinë për Zotin, e megjithatë, duan të shohin prova. E vetmja provë që do t'u jepet, i përgjigjet asaj që i ndodhi profetit Jona.» Pastaj i la dhe u nis.

Jezusi qorton nxënësit

(Mk 8.14-21)

⁵Kur nxënësit u nisën për të kaluar në anën tjetër të liqenit, harruan të merrnin bukë. ⁶Jezusi u tha: «Ruhuni nga tharmi i farisenjve dhe i saducenjve!» ⁷⁻⁸Nxënësit e lidhën këtë me moskryerjen e detyrës së tyre, por Jezusi, duke i ditur mendimet e tyre, u tha: «Pse shqetësoheni, sepse nuk keni bukë? Besëpakë! ⁹Ende nuk kuptoni? Harruat se si ushqeva pesë mijë njerëz me pesë bukë? E sa shporta mbushët me tepricën? ¹⁰Dhe shtatë bukët për katër mijë veta – sa kofinë mbushët në fund? ¹¹Si nuk e kuptoni se nuk ishte fjala për bukë, kur thashë: «Ruhuni nga tharmi i farisenjve dhe i saducenjve?» ¹²Më në fund ata e kuptuan se me tharmin ai nuk nënkuptonte atë që përdoret për pjekjen e bukës, por e kishte fjalën për mësimin e farisenjve dhe të saducenjve.

Dëshmia e Pjetrit për Jezusin

(Mk 8.27-30; Lk 9.18-21)

¹³Kur arriti në krahinën e Cezaresë së Filipit, Jezusi i pyeti nxënësit e tij:

«Ç'thonë njerëzit, kush është Biri i njeriut?» ¹⁴Ata u përgjigjën: «Disa të mbajnë për Gjon Pagëzorin, disa për Elijën, ndërsa disa të tjerë mendojnë se je Jeremia ose një prej profetëve të tjerë.»

¹⁵«Po ju, – i pyeti, – ç'thoni: Kush jam unë?» ¹⁶Simon Pjetri iu përgjigj: «Ti je Mesia – Biri i Perëndisë së gjallë.» ¹⁷Jezusi i tha: «Lum ti Simon, biri i Gjonit, sepse kjo e vërtetë nuk të erdhi nga njeriu. Atë ta dha Ati im qiellor! ¹⁸Prandaj po të them: Ti je Pjetri ♦ (i fortë si shkëmb) dhe mbi këtë shkëmb themelor do të ndërtoj Bashkësinë ♦♦ time. Asnjë armik nuk do ta shkatërrojë, as vdekja. ♦♦♦ ¹⁹Ty do të jap çelësat e mbretërisë së Perëndisë; gjithçka që do të lidhësh këtu mbi tokë, do të jetë lidhur para Zotit; dhe gjithçka që nuk do të zgjidhësh mbi tokë, nuk do të jetë zgjidhur para Zotit.» ♦ ²⁰Pas kësaj Jezusi i porositi me ngulm nxënësit që të mos i tregonin askujt se ai ishte Mesia.

♦ Lojë fjalësh: *Petros* (Pjetër) dhe *Petra* (shkëmb themeli). Shkëmbi i themelit është rrëfimi i Pjetrit. Kështu Pjetri

bëhet i krishteri i parë. ♦♦ Kisha ose bashkësia mesianike. ♦♦♦ fji. dyert e botës së të vdekurve. Ato nuk do të jenë në gjendje ta pengojnë ringjalljen e besimtarëve për jetën e përjetshme. • Ky pushtet (i cili ka të bëjë me disiplinën e kishës) u është dhënë të gjithë dymbëdhjetë apostujve (shih Mt 18,18) dhe më vonë edhe pleqve të kishës (shih 1 Kor 5,4-5).

Shpallja e parë e vdekjes së Jezusit

(Mk 8.31-9.1; Lk 9.22-27)

²¹Që atëherë Jezusi filloi t'u shpjegonte për herë të parë nxënësve se çfarë e priste. «Biri i njeriut duhet të shkojë në Jerusalem. Atje do të vuajë shumë për shkak të këshilltarëve, kryepriftërinjve dhe mësuesve të Ligjit. Do të vritet, por ditën e tretë do të ringjallet.»

²²Pjetri e mori mënjanë dhe filloi ta kundërshtonte me fjalë: «O Zot, nuk duhet të të ndodhë një gjë e tillë.»

²³Por Jezusi u kthye e i tha Pjetrit: «Largohu, o Satan! Ti dëshiron të më largosh nga rruga e Perëndisë! Ajo që ke në mend, nuk i përgjigjet vullnetit të Perëndisë, por dëshirave njerëzore.»

Mbajtja e kryqit pas Jezusit

²⁴Pastaj Jezusi u tha nxënësve të vet: «Kush do të vijë pas meje, duhet të heqë dorë nga vetja si dhe nga dëshirat e tij; duhet të mbajë kryqin e tij dhe të vijë pas meje, rrugës sime. ²⁵Pra, kush do të shpëtojë jetën e tij, do ta humbasë atë. Por kush e humb jetën e vet për mua, do ta gjejë përsëri atë. ²⁶Çfarë do të fitonte njeriu nga kjo, në qoftë se fiton tërë botën, por në fund humbet jetën e tij? ²⁷Biri i njeriut do të vijë vërtet me madhësinë e Atit të tij bashkë me engjëjt e tij, dhe do ta shpërblejë secilin sipas veprave të tij. ²⁸Ju siguroj se disa prej jush që tani qëndroni këtu, edhe në kohën e jetës suaj do ta shihni Birin e njeriut siç do të vijë si mbret.» ♦

♦ Shpërfytyrimi i Jezusit është parashije e ardhjes së tij si mbret dhe gjyqtar në fund të botës. Ndërkohë Jezusi do të vijë si gjyqtar për të shkatërruar Jerusalemin më 70 e.r.

Shpërfytyrimi i Jezusit

(Mk 9,2-13; Lk 9,28-30)

17 Pas gjashtë ditësh, Jezusi mori me vete Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin, vëllanë e tij, dhe shkuan veças në një mal të lartë. ²Pastaj Jezusi u shndërrua para tyre: fytyra i shkëlqeu si dielli dhe rrobat iu bënë të bardha si drita. ³Papritur u shfaqën Moisiu me Elijën duke biseduar me të. ⁴Pas pak Pjetri i tha Jezusit: «O Zot, është mirë të rrimë këtu; në qoftë se dëshiron, po përgatit tri çadra, një për ty, një për Moisiun e një për Elijën.» ⁵Ndërsa po fliste, erdhi papritur një re e shndritshme, zuri vend përmbi ta dhe u dëgjua një zë prej saj që tha: «Ky është Biri im i dashur, i Zgjedhuri im. Atë dëgjoni!» ⁶Nxënësit ranë me fytyrë për tokë dhe u trembën jashtë mase kur dëgjuan këtë zë. ⁷Por Jezusi u afrua, i preku dhe u tha: «Ngrihuni. Mos kini frikë!»

⁸Kur ngritën sytë, panë se aty ndodhej vetëm Jezusi.

⁹Kur po zbritnin nga mali, Jezusi i urdhëroi: «Mos i tregoni askujt për atë që patë, derisa të ringjallet Biri i njeriut.»

¹⁰Pastaj nxënësit e pyetën: «Përse thonë mësuesit e Ligjit se Elija duhet të vijë përsëri para mbarimit të kësaj epoke?» ¹¹Jezusi tha: «Elija, vërtet, duhet të vijë për ta kthyer popullin e Perëndisë në gjendjen e duhur shpirtërore. ¹²Por unë po ju them: Elija tashmë ka ardhur, por ata nuk e njohën, dhe bënë me të çfarë deshën.

Kështu, edhe Biri i njeriut do të vuajë shumë për shkak të tyre.»

¹³Vetëm atëherë nxënësit e kuptuan se ai e kishte fjalën për Gjon Pagëzorin.

Jezusi shëron një djalosh epileptik

(Mk 9.14-29; Lk 9.37-43a)

¹⁴Kur u kthyen tek turma, Jezusi iu afrua një njeri, ra në gjunjë para tij ¹⁵dhe i tha: «Zotëri, ki mëshirë për djalin tim. Vuan nga epilepsia dhe ka kriza aq të tmerrshme, sa që shpesh bie në ujë ose në zjarr. ¹⁶E solla te nxënësit e tu, por ata nuk ishin në gjendje ta shëronin.» ¹⁷Jezusi tha: «Sa njerëz të mbrapshtë jeni; nuk keni aspak besim te Zoti! Deri kur do të jetoj mes jush e t'ju duroj? Silleni këtu djaloshin!» ¹⁸Jezusi e urdhëroi rreptësisht djallin të shporrej, dhe ai doli prej djaloshit, i cili u shërua në çast.

¹⁹Më pas, nxënësit iu afruan Jezusit veças dhe e pyetën: «Përse nuk mund ta dëbonim ne?» ²⁰«Sepse besimi juaj nuk ishte i mjaftueshëm.» – u tha Jezusi. – «Unë po ju them: Në qoftë se besimi juaj do të ishte vetëm si një kokërr sinapi, këtij mali do të mund t'i thoshit: «Dil këndeje e shko atje!» dhe ashtu do të bëhej. Atëherë për ju nuk do të ishte asgjë e pamundur! [²¹Por ky lloj djalli nxirret vetëm me lutje dhe me agjërim.]»

Shpallja e dytë e vdekjes së Jezusit

(Mk 9.30-32; Lk 9.43b-45)

²²Kur nxënësit e Jezusit u bashkuan në Galile, ai u tha: «Së shpejti Biri i njeriut do t'u dorëzohet njerëzve.

²³Ata do ta vrasin, por ditën e tretë ai do të ringjallet.» Nxënësit u trishtuan shumë për këtë.

Për taksën e Tempullit

²⁴Kur Jezusi dhe nxënësit e tij arritën në Kafarnaum, Pjetrit iu afruan ata që mbledhnin taksën e Tempullit dhe i thanë: «A nuk e paguan mësuesi juaj taksën e Tempullit?» ²⁵«E paguan», – u përgjigj Pjetri. Kur Pjetri hyri në shtëpi, Jezusi e pyeti: «Ç'mendon, Simon? Prej kujt e mbledhin taksën dhe tatimin mbretërit e kësaj bote? Prej njerëzve të tyre apo prej të huajve?» ²⁶«Prej të huajve», – i tha Pjetri. Jezusi iu përgjigj: «Kjo do të thotë, pra, se njerëzit e tyre janë të lirë. ²⁷Por ne nuk duam të krijojmë pakënaqësi më kot. Shko në det dhe hidh grepin. Peshkun e parë që të zësh, merre dhe hapi gojën. Atje do të gësh një monedhë. Merre dhe jepja atyre për mua e për ty.»

Udhëzimet për bashkësinë e Zotit

(Mk 9.33-37; Lk 9.46-48)

18 Në të njëjtën kohë nxënësit shkuan te Jezusi dhe e pyetën: «Kush do të jetë më i madhi në mbretërinë e Perëndisë?» ²Jezusi thirri një fëmijë; e vendosi para tyre ³dhe u tha: «Ju siguroj se nuk do të hyni në mbretërinë e Perëndisë në qoftë se nuk e ndryshoni tërë qëndrimin tuaj dhe nuk bëheni si fëmijët. ⁴Kush vlerësohet pak si ky fëmijë, do të jetë më i madhi në mbretërinë e Perëndisë. ⁵Dhe kush pranon në emrin tim një besimtar të thjeshtë, ai më ka pranuar mua.

♦ [Ata u pyetën se kush do të merrte postin më të rëndësishëm në mbretërinë e Perëndisë.](#)

Paralajmërimi për çdo lloj mashtrimi

(Mk 9.42-48; Lk 17.1-2)

⁶Kushdo që mëson ndonjërin nga këta njerëzit e thjeshtë që besojnë në mua, të dyshojë për mua, për të do të ishte më mirë t'i varej në qafë guri i mullirit dhe të hidhej në fund të detit. ⁷Kjo botë i ka punët keq, sepse në të ka gjëra, të cilat mund të bëjnë që njerëzit ta humbasin besimin te Zoti. Vërtet kjo është e pashmangshme; por mjerë ai që është fajtor për këtë.

⁸Në qoftë se dora ose këmba të shpie drejt të keqes, preje dhe flake tej. Është më mirë të hysh në jetën (e përjetshme) pa dorë e pa këmbë, sesa të hidhesh në zjarrin e përjetshëm me të dy duart e me të dy këmbët. ⁹E në qoftë se syri të shpie drejt së keqes, nxirre dhe flake tej! Është më mirë të hysh në jetën (e përjetshme) vetëm me një sy, sesa të hidhesh në zjarrin e ferrit me të dy sytë.

Shëmbëlltyra e deles së humbur

(Lk 15.3-7)

¹⁰Tregoni kujdes që të mos i trajtoni me mendjemadhësi besimtarët e thjeshtë në bashkësi. Ja ku po ju them: Engjëjt e tyre hyjnë lirisht tek Ati im në qiell. ¹¹Çfarë mendoni ju? Çfarë do të bëjë njeriu që ka 100 dele në qoftë se njëra prej tyre humbet rrugën? ¹²A nuk do t'i lërë të kullosin në mal 99 delet, e të shkojë për të kërkuar të humburën? ¹³Dhe kur ta gjejë – unë po ju them: Do të gëzohet më shumë për atë dele sesa për 99 të tjerat që nuk humbën rrugën. ¹⁴Po kështu edhe Ati yt qiellor nuk do që asnjëri prej këtyre besimtarëve të thjeshtë të humbasë rrugën.

Përgjegjësia për bashkëbesimtarin

¹⁵Në qoftë se bashkëbesimtari yt të bën keq, shko tek ai dhe qortoje kur të jeni sy për sy. Në qoftë se bindet, e ke rifituar atë si vëlla. ¹⁶Por në qoftë se ai nuk të dëgjon, atëherë shko përsëri tek ai dhe merr me vete një ose dy njerëz të tjerë, sepse çdo çështje duhet zgjidhur në bazë të pohimeve të dy ose tre dëshmitarëve. ¹⁷Në qoftë se ai nuk i dëgjon as ata, zgjidhe çështjen para kishës. Në qoftë se nuk e dëgjon as bashkësinë, trajtoje si të pafe ose tradhtar. ¹⁸Pra, po ju them: Çdo gjë për të cilën do të vendosni këtu në botë, do të jetë me fuqi ligjore në sy të Zotit; e çdo gjë për të cilën nuk do të vendosni këtu në tokë, nuk do të jetë me fuqi ligjore në sy të Zotit. ♦

¹⁹Por po ju them, gjithashtu: Në qoftë se dy prej jush këtu në tokë do të jenë dakord që t'i luten Zotit për diçka, këtë gjë do t'ua japë Ati im në qiell. ²⁰Aty ku ndodhen vërtet dy ose tre veta të bashkuar në emrin tim, aty jam edhe unë midis tyre.»

♦ [Kjo u drejtua të gjithë dishepujve \(jo vetëm Pjetrit\) dhe kështu pleqve të çdo kisha. Ne e shohim këtë në veprim në Korint, kur pleqtë \(bashkë me Palin\) shkishërojnë një shkelës \(1 Kor 5,1-5\).](#)

Shëmbëlltyra për borxhliun e pamëshirshëm

²¹Atëherë Pjetri iu drejtua Jezusit dhe e pyeti: «Zot, në qoftë se bashkëbesimtari im më bën një të keqe, sa herë duhet ta fal? Deri në 7 herë?» ²²«Jo, jo deri në 7 herë, por deri në 77 herë!» ♦ dhe shtoi:

²³Mbretëria e qiellit është si një mbret që vendosi të rregullonte llogarinë me administratorin e pasurisë së

tij. ²⁴Që në fillim i sollën një njeri që i kishte borxh një shumë prej disa milionash. ²⁵Meqë borxhliu nuk mund ta paguante, mbreti urdhëroi që ai vetë të shitej skllav bashkë me gruan, fëmijët dhe tërë pasurinë e tij, me qëllim që shuma e nxjerrë të përdorej për shlyerjen e borxhit. ²⁶Por borxhliu ra përmbys para tij dhe iu lut: «Ki durim me mua. Do t'i kthej të gjitha!» ²⁷Zotëria pati mëshirë për të, e liroi dhe ia hoqi detyrimin.

²⁸Sapo doli, u takua me një shok, i cili i kishte borxh një shumë të vogël. Atë e kapi për gryke, gati ta mbyste dhe i tha: «Ma kthe borxhin!» ²⁹Borxhliu ra në gjunjë dhe iu lut: «Ki durim me mua. Do t'i kthej të gjitha!» ³⁰Por huadhënësi nuk deshë ta dëgjonte dhe urdhëroi që ta futnin në burg, derisa të paguante borxhin.

³¹Të tjerët, kur e panë këtë, u tronditën. Shkuan te zotëria dhe i treguan se çfarë kishte ndodhur. ³²Ai e thirri njeriun dhe i tha: «Njeri i keq! Unë ta shleva tërë borxhin tënd sepse m'u lute. ³³A nuk duhej që edhe ti të kishe mëshirë për shokun tënd, siç kisha unë për ty?» ³⁴Pastaj ua dorëzoi torturuesve. ♦♦ që të kthente tërë borxhin.

³⁵Kështu do të bëjë me ju edhe Ati im qiellor, në qoftë se nuk ia falni fajin me gjithë zemër bashkëbesimtarit tuaj.»

♦ gjithmonë. Në saje të banimit të Shpirtit të shenjtë te besimtari anulohet hakmarrja.

♦♦ që ta torturonin derisa të tregonte ku i kishte fshehur të hollat.

Nisja për në Jude

(Mk 10.1-12)

19 Pasi u largua nga Galileja dhe arriti në krahinë të Judesë, përtej Jordanit. ²Shumë njerëz i shkuan pas deri atje, dhe ai i shëroi.

Për ndarjen dhe beqarinë

³Iu afruan disa farisenj dhe kërkuan ta futnin në grackë. E pyetën: «A lejohet ta ndajë burri gruan për ndonjë arsye?» ⁴Jezusi u përgjigj: «A nuk keni lexuar ç'është shkruar në Shkrimin e shenjtë? Atje thuhet se Zoti në fillim krijoi burrin dhe gruan. ⁵E tha: *Prandaj njeriu e lë atin dhe nënën e bashkohet me gruan e tij dhe të dy këta bëhen një.* ⁶Ata nuk janë më dy, por një trup i vetëm. Atë që bashkoi Perëndia, njerëzit nuk duhet ta ndajnë.»

⁷Farisenjtë pyetën: «Si ndodh, pra, që sipas Ligjit të Moisiut burri mund ta ndajë gruan e vet me dorëzim të dokumentit të ndarjes?» ⁸Jezusi u përgjigj: «Moisiu jua ka lejuar ndarjen e gruas vetëm sepse jeni zemërgurë. Por në fillim nuk ishte ashtu. ⁹Prandaj po ju them: Kush e ndan gruan e tij dhe martohet me një tjetër, bën tradhti bashkëshortore, me përjashtim të rastit të imoralitetit të mëparshëm.» ♦

¹⁰Atëherë nxënësit i thanë: «Në qoftë se gjendja e burrit ndaj gruas qenka e tillë, atëherë është më mirë që njeriu të mos martohet!» ¹¹Por Jezusi u përgjigj: «Atë që po ju them tani, nuk mund ta kuptojë çdonjeri, por vetëm ata të cilëve Zoti u ka dhënë dhuntinë. Ka arsye të ndryshme, për të cilat disa nuk martohen. ¹²Disa janë të paafte për martesë që nga lindja; disa, si të tredhurit, u bënë të paafte për shkak të një ndërhyrjeje të mëvonshme. Disa heqin dorë nga martesja, sepse merren vetëm me punët e mbretërisë së Perëndisë. Kush mund ta kuptojë, le ta kuptojë!»

♦ khz. Br 22,13-21

Jezusi dhe fëmijët

(Mk 10.13-16; Lk 18.15-17)

¹³Disa njerëz i sollën Jezusit ca fëmijë të vegjël, që të vinte duart mbi ta e të lutej për ta; por nxënësit nuk i lejuan. ¹⁴Jezusi u tha: «Lërin fëmijët të qetë! Mos i ndaloni të vijnë tek unë, sepse pikërisht për ata që janë si këta rri e hapur mbretëria e Perëndisë!» ¹⁵Jezusi vuri duart mbi ta dhe u largua prej andej.

Reziku i pasurisë

(Mk 10.17-31; Lk 18.18-30)

¹⁶Njëherë Jezusit iu afrua një njeri dhe e pyeti: «Mësues, ç'të mirë duhet të bëj unë, që të fitoj jetën e përjetshme?» ¹⁷«Përse më pyet për të mirën?» – iu përgjigj Jezusi. – «Vetëm Njëri është i mirë: Zoti! Në qoftë se dëshiron të kesh jetën e përjetshme, zbato urdhërimet e tij!» ¹⁸«Cilat?» – pyeti njeriu. Jezusi iu përgjigj: «*Mos bëj vrasje! Mos bëj tradhti bashkëshortore! Mos bëj vjedhje! Mos bëj dëshmi të rremë!* ¹⁹*Ndero atin dhe nënën! Dhe dua je të afërmin tënd si vetveten!*» ²⁰«Të gjitha këto i kam zbatuar.» – iu përgjigj djaloshi. – «Ç'duhet të bëj më tepër?» ²¹Jezusi i tha: «Në qoftë se do të angazhohesh tërësisht, atëherë shite tërë pasurinë tënde, jepja të hollat të varfërve dhe do të gjeshe te Zoti pasurinë që nuk humbet kurrë. Pastaj eja pas meje!» ²²Kur e dëgjoi këtë, djaloshi u largua i trishtuar, sepse ishte shumë i pasur.

²³E Jezusi u tha nxënësve të tij: «Me të vërtetë, njeriu i pasur e ka të vështirë të hyjë në mbretërinë e

Perëndisë!²⁴Unë po ju them përsëri: Është më e lehtë për devenë të kalojë nëpër vrimën e gjilpërës, sesa për të pasurin që të hyjë në mbretërinë e Perëndisë.»²⁵Kur e dëgjuan këtë, nxënësit u tmerruan dhe pyetën njëri-tjetrin: «Kush mund të shpëtojë atëherë?»²⁶Jezusi i shikoi me ngulm dhe u tha: «Njerëzit nuk mund ta bëjnë këtë, por për Perëndinë asgjë nuk është e pamundshme.»

²⁷Pjetri mori fjalën dhe i tha Jezusit: «Ti e di se ne lamë çdo gjë dhe u bëmë nxënësit e tu. Çfarë do të nxjerrim nga kjo?»²⁸Jezusi iu përgjigj: «Ju siguroj se kur Zoti ta ripërtërijë botën dhe Biri i njeriut të ulët në fron me gjithë madhësitinë e tij, atëherë ju që u bëtë nxënësit e mi, do të jeni të ulur në dymbëdhjetë frone për të sunduar e për të gjykuar 12 fiset e Izraelit.»²⁹Kushdo që la shtëpinë, vëllezërit, prindërit, fëmijët ose pasurinë e tij për shkakun tim, do t'i marrë përsëri të gjitha këto njëqindfish dhe do të fitojë jetën e përjetshme.³⁰Por shumë veta që tani (mendojnë se) janë përpara, do të qëndrojnë në fund, dhe shumë veta që tani (mendojnë se) janë pas, në fund, do të jenë të parët.» ♦

♦ Kjo i referohet gradës në mbretërinë e Perëndisë, jo në kohën kur ata u bënë besimtarë.

Punëtorët në vresht

20¹Mbretëria e qiellit është si pronari i vreshtit që doli herët në mëngjes për të gjetur punëtorë për vreshtin.²U mor vesh me ta për mëditjen e zakonshme – një monedhë argjendi – dhe pastaj i dërgoi në vresht.³Doli në treg rreth orës nëntë dhe pa disa njerëz të papunë duke ndenjmur kot.⁴A tyre u tha: «Edhe ju mund të punoni në vreshtin tim; unë do t'ju paguaj siç duhet.»⁵Shkuan edhe ata. Kështu bëri edhe në mesditë, edhe rreth orës tre.⁶Doli përsëri rreth orës pesë për herën e fundit në treg, gjeti edhe disa që rrinin atje dhe u tha: «Përse rrini këtu të papunë gjithë ditën?»⁷Ata u përgjigjën: «Sepse askush nuk na mori në punë.» Ai u tha: «Shkoni edhe ju të punoni në vresht!»

⁸Në mbrëmje, pronari i vreshtit i tha administratorit të tij: «Thirri punëtorët dhe jepu pagën! Fillo me ata që erdhën më në fund dhe mbaro me të parët!»⁹U paraqitën kështu ata që kishin filluar rreth orës pesë, dhe morën secili nga një monedhë argjendi.¹⁰Kur u erdhi radha atyre që kishin filluar shumë herët, menduan se do të merrnin më shumë, por edhe ata morën nga një monedhë argjendi.¹¹Filluan ta shanin pronarin¹²duke thënë: «Të tjerët që erdhën më në fund, punuan vetëm një orë dhe ti i barazove me ne. Ne u munduam gjithë ditën në vapë!»¹³Por pronari i vreshtit i tha njërit prej tyre: «I dashuri im, nuk po të bëj padrejtësi! A nuk u morëm vesh për një monedhë argjendi?»¹⁴E more. Tani shko. Unë dua t'i jap edhe këtë të fundit sa ty!¹⁵A nuk më përket mua të bëj siç më pëlqen me pasurinë time? Apo mos vallë ke zili që unë jam shpirtmadh?»

¹⁶Jezusi përfundoi me këto fjalë: «Kështu, pra, ata që (mendojnë se) janë të fundit do të jenë të parët, ndërsa ata që (mendojnë se) janë të parët, do të jenë të fundit.» ♦

♦ Çdo besimtar merr të njëjtin shpërblim: jeten e përjetshme

Shpallja e tretë e vdekjes së Jezusit

(Mk 10.32-34; Lk 18.31-34)

¹⁷Rrugës për në Jerusalem, Jezusi i mori veças dymbëdhjetë nxënësit dhe u tha: ¹⁸«Dëgjoni! Po shkojmë në Jerusalem. Atje Biri i njeriut do t'u dorëzohet kryepërfitorëve dhe mësuesve të Ligjit. Ata do ta dënojnë me vdekje¹⁹dhe do t'ua dorëzojnë të huajve të pafe për ta vënë në lojë, për ta fshikulluar e për ta kryqëzuar. Por ditën e tretë ai do të ringjallet.»

Jo sundimi, por shërbimi

(Mk 10.35-45)

²⁰Jezusit iu afrua gruaja e Zebedeut me të dy djemtë, e përshëndeti me fytyrë përtokë dhe pyeti nëse mund t'i bënte një favor.²¹«Çfarë dëshiron?» – pyeti Jezusi. «Më premto, – tha ajo, – që këta të dy, djemtë e mi, do të rrinë njëri në të djathtën e tjetri në të majtën tënde, kur të hipësh në fuqi.»²²«Ju nuk dini se ç'kërkoni.» – iu përgjigj Jezusi. – «A mund ta pini ju kupën e vuajtjeve që duhet të pi unë?» «Po!» – u përgjigjën ata.²³«Me të vërtetë ju do të pini të njëjtën kupë si unë.» – u tha Jezusi. – «Por nuk më takon të urdhëroj se kush mund të rrijë në të djathtën e kush në të majtën time. Në këto vende do të ulen vetëm ata që ka paracaktuar Ati im.»

²⁴Kur morën vesh dhjetë të tjerët, u zemëruan me të dy vëllezërit.²⁵Prandaj Jezusi i thirri dhe u tha: «Siç e dini, sundimtarët shtypin popujt e tyre dhe të mëdhenjtë shpërdorojnë pushtetin e tyre.»²⁶Por te ju nuk duhet të jetë ashtu. Kush prej jush do të bëhet i madh, duhet t'u shërbejë të tjerëve,²⁷dhe kush do të jetë në krye, duhet të jetë skllav i të gjithëve.²⁸Madje edhe unë, Biri i njeriut, nuk erdha për t'u shërbyer, por për të shërbyer e për të flijuar jetën time si çmim për çlirimin e shumë vetave.»

Shërimi i dy të verbërve

(Mk 10.46-52; Lk 18.35-43)

²⁹Kur po largoheshin nga Jeriho, Jezusit po i shkonte pas një turmë e madhe njerëzish.³⁰Dy të verbër që

rrinin pranë rrugës, dëgjuan se Jezusi po kalonte dhe bërtitën: «O Zot, Biri i Davidit, ki mëshirë për ne!»

³¹Njerëzit u tërhoqën vërejtje, por ata bërtitën edhe më fort: «O Zot, Biri i Davidit, ki mëshirë për ne.»

³²Jezusi u ndal, i thirri të dy dhe i pyeti: «Ç'kërkoni prej meje?» ³³Ata iu përgjigjën: «Që të shohim, o Zot.»

³⁴Jezusi pati mëshirë për ta dhe u preku sytë. Atyre iu kthye shikimi menjëherë dhe shkuan pas tij.

Hyrja mesianike në Jerusalem

(Mk 11.1-11; Lk 19.28-40; Gjn 12.12-19)

21 Pak para Jerusalemit, ata arritën në një fshat me emrin Bet-Page, rrëzë malit të Ullinjve. Atje Jezusi dërgoi përpara dy nxënës ²dhe u tha: "Shkoni në atë fshatin përballë. Atje do të gjeni një gomaricë bashkë me kërricin e saj. Zgjidhni të dy e m'i sillni këtu! ³E në qoftë se ju thotë gjë ndokush, i thoni: «I duhen Zotit». Dhe menjëherë do t'i lëshojë." ⁴Kështu u plotësua ajo që kishte parathënë profeti (Zekarja). ⁵*Tregojini qytetit Jerusalem; mbreti yt i mëshirshëm po vjen tek ti duke ngarë gomaricën dhe kërricin e saj.* ⁶Të dy nxënësit shkuan dhe vepruan sipas urdhrit të Jezusit. ⁷Ia sollën gomaricën dhe kërricin, i vunë rrobat e veta mbi ta, dhe Jezusi hipi mbi gomaricë. ⁸Shumë njerëz i shtruan rrobat e tyre si qilim gjatë rrugës, të tjerët filluan të thyenin degë dhe t'i shtronin rrugës. ⁹Populli që shkante para e pas Jezusit, i brohoriste: «*Hosha-na*, o Biri i Davidit! Rroftë ai që vjen në emër të Zotit! *Hosha-na!* Lavdi Perëndisë në më të lartët qiej!»

¹⁰Kur Jezusi hyri në Jerusalem, u turbullua mbarë qyteti. «Kush është ky?» – pyetnin njerëzit. ¹¹Turma e njerëzve që shoqëronte Jezusin, tha: «Ky është Profeti, Jezusi nga Nazareti i Galilësë.»

Jezusi në Tempull

(Is 56,7; Jr 7.11; Mk 11.15-19; Lk 19.45-48; Gjn 2.13-22)

¹²Jezusi hyri në Tempull dhe i dëboi të gjithë tregtarët e blerësit. Këmbyesve të parave u përmbysi tavolinat kurse shitësve të pëllumbave banakët. ¹³Dhe u tha: «Në Shkrimin e shenjtë thuhet: *Tempulli im do të quhet shtëpi lutjeje (për të gjitha kombet).* ♦ Por ju e shndërruat në skutë batakçish!»

¹⁴Pastaj në Tempull iu afruan të verbrit dhe paralitikët, dhe ai i shëroi. ¹⁵Kur panë mrekullitë që bëri Jezusi, kryepriftërinjtë dhe mësuesit e Ligjit u zemëruan. U inatosën për fëmijët në Tempull që brohoritnin: «*Hoshana*, o Biri i Davidit!» ¹⁶Dhe pyetën Jezusin: «A dëgjon se ç'po brohoritin këta?» Jezusi u tha: «Sigurisht! A nuk e keni lexuar në Shkrimin e shenjtë: *Ti bën që të të lavdërojnë foshnjat dhe të miturit.*»

¹⁷Pastaj Jezusi u largua, doli nga qyteti dhe kaloi natën në Bet-Anje.

♦ [Këta tregtarë po okuponin oborrin e johebrenjeve, që ishte një zonë në tempull ku johebrenjtë mund të luteshin. Kjo tregon se edhe në DhV Perëndia ishte i shqetësuar për ta, ndryshe nga udhëheqësit hebrenj. Përveç kësaj, njerëzit po e përdorin këtë oborr për rrugë që u bien shkurt.](#)

Jezusi dhe fiku

(Mk 11.12-14,20-24)

¹⁸Të nesërmen në mëngjes, Jezusi u kthye në Jerusalem. Rrugës kishte uri. ¹⁹Kur pa një fik pranë udhës, iu afrua; por nuk gjeti gjë tjetër veçse gjethe. Pastaj i tha pemës: «Mos bëfsh kurrë fruta!» Dhe fiku u tha aty për aty.

²⁰Nxënësit e panë këtë plot habi dhe pyetën: «Si ka mundësi që fiku të thahet menjëherë?» ²¹Jezusi u përgjigj: "Ju siguroj se në qoftë se keni besim te Zoti dhe nuk dyshoni, mund të bëni jo vetëm atë që i bëra unë këtij fiku, por mund t'i thoni edhe këtij mali: «Çohu e hidhu në det!», e do të bëhet ashtu. ²²Mjafton që të keni besim dhe do të merrni gjithçka që kërkoni nga Zoti."

Çështja e pushtetit

(Mk 11.27-33; Lk 20.1-8)

²³Jezusi hyri në Tempull dhe u foli njerëzve. Por iu afruan kryepriftërinjtë dhe këshilltarët dhe e pyetën: «Kush të jep të drejtën të paraqitesh këtu? Kush ta dha këtë pushtet?»

²⁴«Do t'ju bëj edhe unë një pyetje.» – u përgjigj Jezusi. – «Në qoftë se më përgjigjeni, atëherë do t'ju tregoj me çfarë pushteti i bëj këto. ²⁵Më thoni: Kush ia dha Gjon Pagëzorit pushtetin për të pagëzuar? Zoti apo njerëzit?» Ata u menduan: "Në qoftë se themi «Zoti», atëherë ai do të na pyesë: «Përse nuk i besuat Gjonit?»

²⁶Por në qoftë se themi: «Njerëzit», atëherë populli do të hidhet kundër nesh, sepse të gjithë janë të bindur se Gjoni ishte profet." ²⁷Prandaj i thanë Jezusit: «Nuk e dimë.» «As unë, pra, – u tha Jezusi, – nuk do t'ju tregoj kush ma dha këtë pushtet.»

Shëmbëlltyra për dy djemtë

²⁸Çfarë mendoni për tregimin që vijon? Një baba kishte dy djem. Iu drejtua të parit e i tha: «Biro, dil sot e puno në vresht!» ²⁹«Nuk dua» – iu përgjigj biri; por më vonë ndërroi mendje dhe shkoi. ³⁰Kështu i tha Ati edhe birit të dytë. «Po shkoj, o atë», – iu përgjigj ai, por në të vërtetë nuk shkoi. ³¹Cili prej të dyve kreu

vullnetin e të atit?”

«I pari» – iu përgjigjën ata. Jezusi u tha: «Ndërsa unë po ju them: Tagrambledhësit dhe prostitutat hyjnë në mbretërinë e Perëndisë më tepër se ju. ³²Gjon Pagëzori erdhi për t'ju treguar rrugën e drejtë, por ju nuk i besuat. Edhe kur patë se si e pranuan lajmin e tij tagrambledhësit dhe prostitutat, ju as e dëgjuat, as ndryshuat qëndrimin dhe sjelljen tuaj!»

Shëmbëlltyra e vreshtarëve të këqij

(Mk 12.1-12; Lk 20.9-19)

³³Dëgjoni shëmbëlltyrën tjetër: ishte një pronar që kishte mbjellë një vresht, e kishte rrethuar me gardh, kishte ndërtuar shtrydhësen e rrushit dhe kishte ngritur kasollen e vrojtimit. Pastaj ua besoi vreshtin vreshtarëve të tij dhe u nis. ³⁴Në kohën e të vjelave dërgoi te vreshtarët lajmëtarët e vet për të marrë prodhimin që i takonte. ³⁵Por punëtorët njërin e rrahën, një tjetër e mbytën e një tjetër e vranë me gurë. ³⁶Pronari dërgoi edhe njëherë lajmëtarë, më shumë se herën e parë; edhe këtyre ua bënë ashtu.

³⁷Në fund dërgoi të birin, sepse mendonte: «Të paktën do të kenë respekt për djalin tim.» ³⁸Por kur e panë duke u afruar, vreshtarët i thanë njëri-tjetrit: «Ky është trashëgimtari. Ta vrasim dhe vreshti do të na takojë neve.» ³⁹Kështu e kapën, e nxorën nga vreshti dhe e vranë.

⁴⁰Tani, kur të vijë vetë pronari i vreshtit, ç'do t'u bëjë ai vreshtarëve?» – i pyeti Jezusi. ⁴¹Ata thanë: «Do t'i zhdukë këta keqbërës dhe do t'ua besojë të tjerëve vreshtin e tij, të cilët do t'ia japin prodhimin porsa të vijë koha e të vjelave.» ⁴²Jezusi i pyeti: «Kurrë nuk e lexuat atë që është shkruar në Shkrimin e shenjtë: *Guri që ndërtuesit hodhën tej, është bërë tani guri i qoshes. Zoti e bëri këtë mrekulli ♦ dhe ne e pamë?* ⁴³

⁴⁴Kush do të bjerë në këtë gur ♦♦ do të dërrmohet, dhe kujt do t'i bjerë ♦♦♦ ky gur, ai do të copëtohet. Prandaj po ju them: Mbretëria e Perëndisë do t'ju hiqet. • Ajo do t'i jepet popullit që do të veprojë sipas kërkesave të kësaj përgjegjësie.»

⁴⁵Kryepiftërinjtë e farisenjtë vunë re se të dyja shëmbëlltyrat u drejtoheshin atyre. ⁴⁶Donin ta arrestonin Jezusin, por nuk guxuan, sepse populli e mbante për profet.

♦ të ringjalljes. ♦♦ d.m.th. kush nuk pranon të besojë në Mesinë. ♦♦♦ kush do të dënohet nga Mesia. • privilegji i shërbimit të Perëndisë.

Shëmbëlltyra e krenimit të dasmës

(Lk 14.15-24)

22 Jezusi u tregoi edhe një shëmbëlltyrë tjetër: ²Mbretëria e qiellit është si një mbret që bëri dasmën për djalin e tij. ³Kishte dërguar shërbëtorët e tij për të thirrur në dasmë të ftuarit; por ata nuk donin të vinin. ⁴Prandaj dërgoi tek ata shërbëtorë të tjerë dhe u tha të thoshin: «Gostinë e kam gati: demat dhe bagëtitë e majme i thera! Gjithçka është gati! Ejani në dasmë!» ⁵Por ata nuk ia vunë veshin: njëri shkoi në arën e tij, tjetri në dyqanin e tij. ⁶Disa të tjerë, madje, i kapën shërbëtorët e mbretit, i rrahën dhe i vranë.

⁷Prandaj mbreti u zemërua dhe dërgoi ushtrinë e tij. Ushtarët i vranë këta vrasës dhe qytetin e tyre e bënë shkumb e hi. ⁸Pastaj u tha shërbëtorëve të tij: «U bënë përgatitjet për dasmë, por të ftuarit e treguan që nuk e meritonin. ⁹Tani shkoni në rrugë të madhe e thirrni në dasmë cilindo që të hasni.» ¹⁰Shërbëtorët dolën në rrugë dhe sollën të gjithë ata që gjetën: të mirë e të këqij. Kështu, salloni i dasmës u mbush me të ftuar.

¹¹Kur hyri për të parë të ftuarit, mbreti vuri re aty një njeri që nuk kishte veshur petkun e dasmës. I tha:

¹²«Si hyre këtu pa veshur petkun e dasmës?» Njeriu heshti. ¹³Mbreti u tha shërbëtorëve: «Lidheni këmbë e duar dhe nxirreni jashtë në terr, ku të vajtojë e të kërcëllijë dhëmbët!» ¹⁴Ka vërtet shumë të ftuar, por pak të zgjedhur.»

Çështja e pagimit të tatimit

(Mk 12.13-17; Lk 20.20-26)

¹⁵Pas pak farisenjtë vendosën ta zinin Jezusin në grackë me një pyetje delikate. ¹⁶Dërguan te Jezusi njerëzit e tyre bashkë me disa anëtarë të partisë së Herodit; ♦ ata i thanë: «Mësues, ne e dimë se ti merresh vetëm me të vërtetën. Ti i tregon secilit hapur se si duhet të jetojë sipas vullnetit të Zotit. Ti nuk lejon të ndikohesh vërtet nga njerëzit, edhe në qoftë se ata janë me ndikim. ¹⁷Prandaj na thuaj mendimin tënd: a lejohet sipas Ligjit tonë t'i paguhet Cezarit romak tatimi apo jo?» ¹⁸Jezusi e nuhati keqdashjen e tyre dhe tha: «Hipokritë, ju doni të më zini ngushtë? ¹⁹Më tregoni njërin prej monedhave me të cilat e paguan tatimin.» ²⁰Ata i nxorën një monedhë argjendi dhe ai i pyeti: «E kujt është kjo fytyrë e ky mbishkrim?» ²¹«E Cezarit!» – iu përgjigjën ata. Jezusi tha: «Kthejini, pra, Cezarit atë që i takon Cezarit, dhe Perëndisë atë që i takon Perëndisë.» ²²Kur e dëgjuan përgjigjen, u habitën dhe u larguan pa bërë zë.

♦ Ky fraksion deshte të qeverisej nga një anëtar i familjes së Herodit dhe jo nga një guvernator romak.

Ringjallja e të vdekurve

(Mk 12.18-27; Lk 20.27-40)

²³Atë ditë shkuan tek ai disa saducenj. — Saducenjët pohojnë se nuk ka ringjallje ♦ — ²⁴“Rabin, – i thanë ata, – Moisiu ka vendosur që në qoftë se një njeri i martuar vdes pa lënë fëmijë, atëherë i takon të vëllait të martohet me vejushën për t’i lënë pasardhës. ²⁵Tani, midis nesh kishte shtatë vëllezër. Më i madhi u martua dhe vdiq pa lënë fëmijë dhe ia la gruan vëllait të tij. ²⁶Pastaj i dyti u martua me vejushën, por edhe ai vdiq pa lënë fëmijë; edhe të tretit i ndodhi ashtu. Kështu ndodhi me të gjithë deri tek i shtati! ²⁷Më në fund vdiq edhe gruaja. ²⁸Në këtë «ringjallje», pra, e cilit prej këtyre të shtatëve do të jetë gruaja, sepse të gjithë e kishin për grua?”

²⁹«Gaboni plotësisht, – u pergjigj Jezusi, – sepse nuk e kuptoni as Shkrimin e shenjtë, as fuqinë e Perëndisë. ³⁰Pas ringjalljes nuk do të ketë martesë, sepse njerëzit e ringjallur do të jenë si engjëjt në qiell.

³¹E përsa i përket ringjalljes nga të vdekurit, siç duket, nuk keni lexuar kurrë që Zoti tha: ³²*Unë jam Perëndia e Avrahamit, i Izakut dhe i Jakovit*. Ai është Perëndia e të gjallëve, e jo i të vdekurve!» ³³Kjo pergjigje u bëri dëgjuesve përshtypje të thellë.

♦ As saducenjët as samaritanët nuk besonin në ringjallje. Esenët besonin vetëm në mbijetesën e shpirtit, kurse farisenjtë nuk besonin në një trup mbinatyror.

Urdhërimi më i madh

(Mk 12.28-34; Lk 10.25-28)

³⁴Kur farisenjtë vunë re se Jezusi ua kishte mbyllur gojën edhe saducenjve, ata u bashkuan. ³⁵Njëri prej tyre, mësues i Ligjit, donte ta zinte Jezusin në grackë, prandaj e pyeti: ³⁶«Mësues, cili është urdhërimi më i madh i Ligjit?» ³⁷Jezusi u pergjigj: «*Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë vullnet dhe me gjithë mend!*» ³⁸Ky është urdhërimi më i madh dhe më i rëndësishëm. ³⁹I dyti është po aq i rëndësishëm: *Duaje të afërmin tënd si vetveten!* ⁴⁰Në këto dy urdhërime përfshihet ajo që Perëndia kërkon në Ligj dhe në librat e Profetëve.»

Biri i Davidit apo Zoti i Davidit?

(Mk 12.35-37; Lk 20.41-44)

⁴¹Pastaj Jezusi iu drejtua farisenjve të mbledhur dhe i pyeti: ⁴²«Ç’mendonin ju për Mesinë? Biri i kujt është ai?» «I Davidit», – u pergjigjën ata. ⁴³Jezusi tha: «Atëherë pse e quan Davidi, i frymëzuar nga Shpirti i shenjtë, Zot të vetin? Davidi tha vërtet: ⁴⁴*Perëndia, Zoti, të thotë ty, Zoti dhe Mbreti im: «Ulu në të djathtën time gjersa t’i nënshtroj armiqët e tu dhe t’i vë për shtrojë të këmbëve të tua.»* ⁴⁵Përderisa Davidi e quan atë vetë Zotin e tij, si ka mundësi që ai të jetë (vetëm) biri i tij?» ⁴⁶Askush nuk arriti t’i pergjigjej. Që atëherë nuk guxonte askush ta pyeste më.

Paralajmërimi për t’u ruajtur nga farisenjtë dhe mësuesit e Ligjit

(Mk 12.38-39; Lk 11.43, 46; 20.45-46)

23 Pastaj Jezusi iu drejtua turmës dhe nxënësve të tij, ²dhe u tha: ³“Mësuesit e Ligjit dhe farisenjtë janë shpjeguesit zyrtarë të Ligjit që ju ka dhënë Moisiu. ⁴Ju duhet, pra, ta dëgjoni dhe ta zbatoni atë që urdhërojnë ata. ♦ Por ju nuk duhet të drejtoheni sipas sjelljes së tyre, sepse ata vetë nuk e zbatojnë atë që japin mësim. ⁵Ata lidhin barrë të rënda, ua ngarkojnë ato njerëzve, kurse vetë nuk lëvizin as gishtin që t’i mbajnë. ⁶Gjithçka që bëjnë, është vetëm me qëllim që t’i shohin njerëzit. Ata mbajnë rripa lutjesh dhe tufa fijesh veçanërisht të gjata në rrobat e tyre që të bien në sy. ⁷Në gosti dëshirojnë kryet e vendit, në shërbesa nëpër sinagoga ulen në vendet e para. ⁸Pranojnë me dëshirë përshtypje të ndershme në sheshe dhe me kënaqësi lejojnë t’i quajnë njerëzit «rabin» (mësuesi i shkëlqyeshëm). ⁹Por ju mos lejoni t’ju quajnë «rabinë», sepse jeni të gjithë vëllezër dhe vetëm njëri (Mesia) është Mësuesi juaj. ¹⁰Edhe këtu në tokë mos e quani asnjërin «atë», sepse keni vetëm një Atë — atë që është në qiell! ¹¹Gjithashtu, mos lejoni t’ju quajnë udhëheqës, sepse keni vetëm një udhëheqës — Mesinë! ¹²Për këtë më i madhi ndër ju le të jetë shërbëtori juaj. ¹³Dhe pikërisht kush ngrihet lart, atë do ta poshtërojë Zoti; por kush nuk e vlerëson veten, atë do ta lartësojë Zoti.”

♦ d.m.th. me kusht se mësimi i tyre përputhet me atë të Moisiut.

Jezusi qorton farisenjtë dhe mësuesit e Ligjit

(Mk 12.40; Lk 11.39-42, 44, 52; 20.47)

¹³«Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Ju ua mbyllni njerëzve derën për në mbretërinë e Perëndisë! Ju vetë nuk hyni, as lejoni të hyjnë ata që duan. ¹⁴Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Ju bëni lutje të gjata, që të lini përshtypje të mira, kurse, në të vërtetë, jeni mashtrues që ua hiqni me mashtrim vejushave pasurinë e tyre. Ju do të dënoheni në mënyrën më të rreptë. ¹⁵Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Ju endeni nëpër tërë botën për të fituar një anëtar të partisë

suaj, e kur e gjeni, e bëni atë një kandidat për ferrin dy herë më të keq se veten tuaj! ♦

¹⁶Mjerë ju! Ju doni t'i udhëhiqni të tjerët, kurse vetë jeni të verbër! Ju thoni: Kush betohet për Tempullin, nuk është i lidhur; kurse kush betohet për arin e Tempullit, atëherë është i lidhur. ¹⁷Ja ç'jeni ju, të marrë e të verbër! Po cili është më i rëndësishëm: ari apo Tempulli që ia kushton arin Zotit? ¹⁸Gjithashtu, ju thoni: Kush betohet për altarin, nuk është i lidhur; kurse kush betohet për flijimin që është mbi altar, atëherë është i lidhur! ¹⁹Të verbër! Çfarë është më e rëndësishme: dhurata e flijuar apo altari që ia kushton flijimin Zotit? ²⁰Kush betohet për altarin, betohet edhe për gjithçka që është mbi të, ²¹dhe kush betohet për Tempullin, betohet edhe për Zotin që banon atje. ²²Kush betohet për qiellin, betohet për fronin e Perëndisë dhe për Perëndinë që rri mbi të.

²³Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Ju i jepni Zotit të dhjetën e gjithçkaje që keni, edhe të erëzave, si të dhjetën e mendrës, të koprës dhe të qimnonit, por nuk e çani kokën për atë që është më e rëndësishme në Ligj: drejtësinë, mëshirën dhe besnikërinë. E pikërisht ato duhet t'i plotësoni pa lënë pas dore të tjerat. ²⁴Ju dëshironi të udhëhiqni të tjerët, kurse vetë jeni të verbër! Kur kulloni verën në gotë, ju hiqni mushkonjën, por kapërdini devenë!

²⁵Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Gotat dhe enët tuaja i mbani të pastra nga ana e jashtme, por ato që pini e që hani, i keni vjedhur në saje të lakmisë suaj. ²⁶Farisenj të verbër! Shikoni së pari pastërtinë e brendshme, atëherë të gjitha të jashtmet do të jenë të pastra.

²⁷Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Ju u ngjani varreve të zbardhuara me gëlqere, që duken të bukura përjashta, por përbrenda kanë eshtra të vdekurish me gjithfarë ndyrësie. ²⁸Kështu jeni edhe ju; përjashta njerëzve u dukeni të përshtirshëm, kurse përbrenda jeni krejt hipokrizi e padrejtësi.

♦ sepse të dy besojnë se mund ta meritojnë shpëtimin e tyre me veprat e tyre.

Dënimi do të vijë

(Lk 11.47-51)

²⁹Mjerë ju, mësuesit e Ligjit dhe farisenj! Hipokritë! Ju u ndërtoni profetëve varre madhështore dhe stolisni varret e besnikëve ndaj Ligjit. ³⁰E thoni: Në qoftë se ne do të jetonim në kohën e të parëve, nuk do t'i ndihmonim me vrasjen e profetëve. ³¹Me këtë e pranoni se jeni pasardhësit e këtyre vrasësve të profetëve. ³²Vazhdoni e mbushni kupën e të parëve tuaj!

³³Ju gjarpërinj! Si do t'i shpëtoni dënimit me ferr? ³⁴Dëgjoni mirë! Unë do t'ju dërgoj profetë, njerëz të urtë dhe mësues të vërtetë të Ligjit. Disa prej tyre do t'i vritni, disa do t'i kryqëzoni, dhe të tjerët do t'i fshikulloni në sinagogat tuaja dhe do t'i ndiqni nga njëri qytet në tjetrin. ³⁵Kështu, mbi ju do të bjerë përgjegjësia për vrasjen e të gjithë të pafajshmëve, nga Abeli gjer te Zekarja, biri i Berekisë, të cilin e vratë midis shtëpisë së Tempullit dhe altarit për flijimet e përkushtimit. ♦ ³⁶Unë po ju them: Dënimi për të gjitha këto vepra të poshtra do të bjerë mbi këtë brez!

♦ Kjo tregon se Zakaria, biri i Berekisë ishte martiri i fundit i periudhës së DhV, por në II Kron 24,20 ai quhet nip i priftit Jehojada, ndoshta pas gjyshit të tij të famshëm, i cili kohët e fundit vdiq në moshën 130-vjeçare (II Kronik 24,15). Mateu duhet të ketë pasur qasje në dokumente që e përmend babanë e tij.

Vajtimi për Jerusalem

(Lk 13.34-35)

³⁷O Jerusalem, Jerusalem, ti i vret profetët dhe mbyt me gurë lajmëtarët që të dërgon Zoti. Sa herë desha t'i bashkoja banorët e tu si klluçka zogjtë nën krahët e saj, por ti nuk deshe! ³⁸Prandaj Zoti do ta braktisë Tempullin tënd dhe Tempulli do të mbetet i shkretuar! ³⁹Unë po ju them: Nuk do të më shihni më qysh tani e derisa të thërritni: *Rroftë ai që vjen në emër të Zotit!*»

Shpallja e shkatërrimit të Tempullit

(Mk 13.1-2; Lk 21.5-6)

24 Kur Jezusi doli nga Tempulli e po largohej, iu afruan nxënësit për t'i treguar me gisht ndërtesat e Tempullit. ²Por Jezusi tha: «A po i shihni të gjitha këto? Ju siguroj se këtu nuk do të mbetet asnjë gur mbi gur. Gjithçka do të rrafshohet.»

Fillimi i vështirësive për Izraelin

(Mk 13.3-13; Lk 21.7-19)

³Pastaj Jezusi iu ngjiti malit të Ullinjve. U ul dhe nxënësit iu afruan. Ata e pyetën: «Na trego kur do të ndodhin këto dhe cila do të jetë shenja e ardhjes sate dhe e mbarimit të kësaj epoke?»

⁴Jezusi u përgjigj: «Kini kujdes që të mos ju mashtrojë ndokush. ⁵Shumë veta do të paraqiten nën emrin tim dhe do të pohojnë: «Unë jam Mesia!» Kështu, ata do të mashtrojnë shumë njerëz. ⁶Mos u trembni kur larg e afër të shpërthejnë luftëra. Të gjitha këto do të ndodhin, por ende nuk do të vijë fundi! ⁷Një popull do të luftojë kundër tjetrit, një shtet do të sulmojë tjetrin. Kudo do të ketë uri dhe tërmete. ⁸Por të gjitha këto janë vetëm fillimi i fundit – si fillimi i dhembjeve të lindjes.»

⁹«Pas kësaj njerëzit do t'ju dorëzojnë, do t'ju torturojnë dhe do t'ju vrasin. Mbarë bota do t'ju urrejë sepse më takoni mua. ¹⁰Pastaj shumë veta do të heqin dorë nga feja dhe do ta tradhtojnë e urrejnë njëri-tjetrin.

¹¹Shumë profetë të rremë do të paraqiten dhe do të udhëheqin në rrugë të gabuar shumë njerëz.

¹²Meqenëse do të triumfojë e keqja, dashuria do të shuhet te shumica. ¹³Por kush qëndron i patundshëm deri në fund, do të shpëtojë. ¹⁴Por më parë do të shpallet lajmi i mirë në mbarë tokën, që të gjithë të dëgjojnë për ftesën në mbretërinë e Perëndisë. Vetëm atëherë do të vijë mbarimi.

Ngushtica e madhe

(Mk 13.14-23; Lk 21.20-24)

¹⁵Në Tempull do të futet shtatorja idhujtare e egërsirës shkretimprurëse, për të cilën shkruhet në librin e profetit Daniel. – Kush e lexon këtë, le të mendojë ç'do të thotë kjo! – ¹⁶Kur ta shohin atje, të gjithë banorët e Judesë duhet të ikin në mal. ¹⁷Kush të ndodhet mbi tarracë, mos të zbresë për të marrë ndonjë gjë në shtëpinë e tij. ¹⁸Kush të ndodhet në arë, mos të kthehet për të marrë pallton e tij. ¹⁹Kjo kohë do të jetë veçanërisht e vështirë për gratë shtatzëna e për ato që do t'u japin gji foshnjave. ²⁰Lutjuni Zotit që të mos ju duhet të ikni në dimër ose një të shtunë. ²¹Ajo që do të ndodhë, do të jetë vërtet më e tmerrshme se gjithçka që ka ndodhur qysh nga fillimi i botës ose që do të ndodhë ende. ²²Në qoftë se Zoti nuk do ta shkurtonte atë kohë të terrorit, asnjëri nuk do të shpëtonte gjallë. Por ai e shkurttoi për hir të të zgjedhurve të tij.» ♦

²³Në qoftë se atëherë ndokush të thotë: «Ja, këtu është Mesia!» ose «Atje është!» – mos i besoni! ²⁴Do të paraqiten vërtet mesit të rremë dhe profetë të rremë. Ata do të bëjnë mrekulli të mëdha, aq sa t'i mashtrojnë, po të ishte e mundur, edhe të zgjedhurit. ²⁵Mos e harroni, këtë jua kam parashikuar!

²⁶Prandaj, në qoftë se thonë: «Ja tek është (Mesia) në shkretëtirë», mos dilni! Ose në qoftë se thonë: «Ja tek është në strehim», mos besoni! ²⁷Biri i njeriut do të vijë vërtet papritur e në mënyrë të dukshme për të gjithë, si vetëtimja që dridhet në qiell prej lindjes deri në perëndim. ²⁸Ku ka kërmë, mbliidhen shkabat.»

♦ Kjo nuk i referohet Izraelit në tërësi, por besimtarëve (hebrejve) (shih Isaia 65,8-9) pasi na thuhet diku tjetër (2 Sel 2) se kombi hebre në tërësi do të mashtrohet nga antikristi (mesia e rremë).

Ardhja e Birit të njeriut

(Mk 13.24-27; Lk 21.25-28)

²⁹Pak pas kësaj kohe të terrorit, dielli do të nxihet, hëna nuk do të ndritë më, yjë do të bien nga qielli dhe trupat qiellore do të lëkunden. ♦ ³⁰Pastaj në qiell do të duket shenja: Biri i njeriut. Të gjitha fiset e tokës do të qajnë dhe do ta shohin Birin e njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe madhësi të paparë. ³¹Kur t'i bjerë borisë, ai do t'i dërgojë engjëjt e tij nga të gjitha anët e horizontit për t'i bashkuar të zgjedhurit e tij ♦♦ kudo qofshin në botë.

♦ Kjo do të tregojë rënien e këtij rendi botëror të tanishëm dhe fuqive kozmike që e kontrollojnë atë. ♦♦ Kjo mjaft qartë i referohet rrëmbimit të Kishës dhe jo askimit të Izraelit, që paraqet një pamje mjaft të ndryshme (shih Isaia 60,8-9 dhe 66,20).

Shëmbëlltyra e fikut

(Mk 13.28-31; Lk 21.29-33)

³²Le të nxjerrim mësim nga fiku. Kur të derdhet lëngu në degë e të çelin gjethet, ta dini se vera është afër.

³³Kështu është edhe kur ta shihni se po afrohen të gjitha këto; ♦ atëherë dijeni se ju pret menjëherë fundi.

³⁴Unë po ju them: Ky brez do t'i përjetojë këto të gjitha. ♦♦

³⁵Qielli e toka do të zhduken, por fjalët e mia nuk do të bien poshtë.

³⁶Por askush nuk e di ditën ose orën kur do të ndodhë kjo – askush, as engjëjt në qiell, as Biri; vetëm Ati e di.

♦ shenjat në qiell. ♦♦ ngjarjet lidhur me pushtimin e Jerusalemit nga romakët.

Ndarja vendimtar ndërsa Israel

(Mk 13.32-37; Lk 17.26-30, 34-36; Mt 13.36-43)

³⁷Kur të vijë Biri i njeriut, do të jetë si në kohën e Noahut. ³⁸Atë kohë para përmytjes së madhe, njerëzit hanin e pinin si zakonisht, burrat merrnin gra e gratë burra – deri në ditën kur Noahu hyri në anijen e madhe. ³⁹Nuk u shkonte nëpër mend që do t'u ndodhte gjë derisa erdhi përmytja dhe i fshiu. Kështu do të jetë kur të vijë Biri i njeriut. ⁴⁰Nga dy veta që do të gjenden në arë, njëri do të merret e tjetri do të lihet. ♦

⁴¹Nga dy gra që do të bluajnë në mokër, njëra do të merret e tjetra do të lihet.

⁴²Prandaj rriini zgjuar, sepse nuk e dini se në ç'ditë do të vijë Zoti juaj. ⁴³Mos harroni: Po ta dinte përpara i zoti i shtëpisë se në ç'orë të natës do t'i vinte vjedhësi, do të rrinte zgjuar për të shmangur grabitjen.

⁴⁴Prandaj rriini gati në çdo kohë, sepse Biri i njeriut do të vijë në atë orë kur ju nuk e pritni.» ♦♦

♦ d.m.th. në mbretërinë e Perëndisë në Izrael = do të shpëtohet. ♦♦ Ne e dimë përafërsisht kur do të vijë, sepse duhet të ndodhin disa gjëra më parë (shih 2 Sel. 2), por jo kohën e saktë.

Shërbëtori besnik

(Lk 12.41-48)

⁴⁵Silluni si shërbëtori besnik dhe i mençur, të cilin i zoti e ngarkoi me mbikëqyrjen e të gjithë shërbëtorëve të tjerë për t'i dhënë secilit racionin në kohën e duhur. ⁴⁶Lum ai shërbëtor që, kur të kthehet i zoti, e gjen në punë. ⁴⁷Ju siguroj se i zoti do t'i besojë të gjithë pasurinë e tij. ⁴⁸Por në qoftë se ai është i pabesë dhe thotë me vete: «Zoti im do të vonohet» ⁴⁹e fillon t'i rrahë shokët e tij e të bëjë gosti me pijanecë, ⁵⁰atëherë i zoti do të kthehet një ditë krejtësisht papritur. ⁵¹Ai do ta zhdukë shërbëtorin që nuk parandiente asgjë dhe do ta dërgojë atje ku hipokritët vuajnë dënimin e tyre. Atje do të ketë vaj dhe kërcëllim dhëmbësh.»

Shëmbëlltyra e dhjetë vajzave

25Atëherë mbretërisë të qiellit do t'i ndodhë si në tregimin që po vijon: Dhjetë vajza dolën me kandilat e tyre, që të prisnin dhëndrin. ²Pesë prej tyre vepruan me mend, kurse pesë të tjerat pa mend. ³Të fundit morën me vete vetëm kandilat, ⁴kurse të mençurat morën edhe rezervat e vajit. ⁵Meqë dhëndri u vonua, ato u lodhën të gjitha dhe i zuri gjumi. ⁶Rreth mesnatës u dha lajmi: «Po vjen dhëndri! Dilini përpara!» ⁷Të dhjetë vajzat u zgjuan dhe rregulluan kandilat e tyre. ⁸Pastaj të pamëcurat thanë: «Kurrsesi! Që të mos na mungojë vaji as neve dhe as juve, më mirë shkoni tek tregtarët e blini për vete!» ¹⁰Ato u nisën për të blerë vaj. Ndërkohë dhëndri arriti. Pesë të mençurat që ishin të përgatitura, hynë bashkë me të në dasmë dhe dera u mbyll pas tyre. ¹¹Në fund erdhën edhe të tjerat dhe bërtitën: «O Zot, na e hap derën!» ¹²Por dhëndri nuk i priti e tha: «Nuk ju njoh fare!» ¹³Prandaj rriini zgjuar se nuk dini as ditën, as orën.

Shëmbëlltyra e parasë së besuar

(Lk 19.11-27)

¹⁴Ndodh si me njeriun që u nis për rrugë. Ai thirri më parë shërbëtorët dhe u besoi atyre pasurinë e tij. ¹⁵Njërit i dha pesëqind monedha ari, tjetrit dyqind monedha dhe të tretit njëqind monedha, secilit sipas aftësisë. Pastaj u nis. ¹⁶I pari që kishte marrë pesëqind monedha, menjëherë bëri tregti dhe e dyfishoi shumë. ¹⁷Kështu veproi edhe i dyti; u shtoi dyqind monedhave edhe dyqind të tjera. ¹⁸Por ai që kishte marrë vetëm njëqind monedha, i fshehu paratë e të zotit nën dhe. ¹⁹Pas një kohe të gjatë i zoti u kthye dhe u kërkoi shërbëtorëve llogari. ²⁰I pari, që kishte marrë pesëqind monedha ari, doli e tha: «O zot, më ke besuar pesëqind monedha dhe unë kam fituar edhe pesëqind monedha të tjera; ja ku janë!» ²¹«Shumë mirë, – i tha i zoti, – ti je njeri i mirë dhe besnik. Ti dole besnik në gjëra të vogla, prandaj do të të besoj gjëra më të mëdha. Eja në gostinë time e gëzohu bashkë me mua.» ²²Pastaj erdhi ai me dyqind monedha e tha: «Ti më dhe dyqind monedha, dhe unë kam fituar edhe dyqind.» ²³«Shumë mirë, – i tha i zoti, – ti je njeri i mirë e besnik. Ti dole besnik në gjëra të vogla, prandaj unë do të të besoj gjëra më të mëdha. Eja në gostinë time e gëzohu bashkë me mua.» ²⁴Më në fund erdhi ai që kishte marrë njëqind monedha e tha: «O zot, unë e dija se ti je njeri i ashpër. Ti korr ku nuk mbolle, dhe mbledh ku nuk hodhe.» ²⁵Prandaj kisha frikë dhe e kam fshehur paranë nën dhe. Ja, po ta kthej.» ²⁶I zoti i tha: «Ti je dembel e përtac! Meqenëse e ke ditur se korr ku nuk mbolla dhe mbledh ku nuk hodha, ²⁷atëherë pse nuk e depozitove paranë time në bankë? Dhe tani do ta kisha marrë përsëri me kamatë. ²⁸Merrjani pjesën dhe jepjani atij që ka pesëqind monedha. ²⁹Atij që ka vërtet (fituar shumë), do t'i jepet edhe më shumë dhe ai do të ketë me shumicë, e atij që nuk ka (fituar) asgjë, do t'i merret edhe depozita e vogël që ka!» ³⁰E këtë përtac nxirreni përjashta në terr, ku do të ketë vaj e kërcëllim dhëmbësh.» ♦♦

♦ bëhet fjalë për një farise tipik. Duhet marrë parasysh se shumica e shëmbëlltyrave u drejtoheshin parimisht dëgjuesve çifutë, e vetëm tërthorazi kishës.

Delet dhe dhitë

³¹Kur të vijë Biri i njeriut me madhësinë e tij, dhe bashkë me të të gjithë engjëjt, atëherë do të ulet mbi fronin e tij madhështor. ³²Para tij do të mbledhen njerëz nga të gjithë popujt ♦ dhe ai do t'i ndajë në dy grupe, si bariu që ndan delet prej cjepeve. ³³Delet do t'i vërë në anën e djathtë, kurse cjeptë në të majtën.

³⁴Pastaj Mbreti do t'u thotë atyre që janë në anën e djathtë: «Afrohuni, ju që Ati im ju beko! Merreni për pronë mbretërinë që ju caktoi Zoti që nga fillimi i botës, ³⁵sepse pata uri e më dhatë për të ngrënë, pata etje e më dhatë për të pirë; isha shtegtar e më dhatë strehë; isha pa veshje e më veshët; ³⁶isha i sëmurë dhe erdhët të më shihni; isha në burg dhe erdhët për të më vizituar.»

³⁷Pastaj ata që e kryen vullnetin e Zotit, do të thonë: «O Zot, kur të pamë të uritur e të dhamë për të ngrënë, të etur e të dhamë për të pirë? ³⁸Kur të pamë shtegtar e të dhamë strehë, pa veshje e të veshëm? ³⁹Ose, kur të pamë të sëmurë apo në burg e erdhëm për të të vizituar?» ⁴⁰Dhe Mbreti do t'u përgjigjet: «Ju siguroj se çdo gjë që bëtë për njërin nga këta nxënësit e mi të vegjël, e bëtë për mua.»

⁴¹Pastaj mbreti do t'u thotë atyre që do të jenë në të majtë: «Ikni prej meje, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin e për engjëjt e tij, ⁴²sepse isha i uritur e nuk më dhatë për të ngrënë, isha i etur e nuk më dhatë për të pirë, isha shtegtar e nuk më dhatë strehë, ⁴³isha pa veshje e nuk më veshët, isha i sëmurë dhe në burg e nuk erdhët për të më vizituar.»

⁴⁴Pastaj edhe ata do ta pyesin Mbretin:

«O Zot, kur të pamë të uritur, a të etur, a shtegtar, a pa veshje, a të sëmurë, a në burg e nuk u kujdesëm për ty?» ⁴⁵Dhe ai do t'u përgjigjet: «Ju siguroj se çdo gjë që nuk bëtë për njërin prej këtyre nxënësve të mi të vegjël, nuk e bëtë as për mua.»

⁴⁶Këta do të shkojnë në mundim të përjetshëm, kurse të tjerët, që e kryen vullnetin e Zotit, do të shkojnë në jetën e përjetshme.»

♦ Aludim për diasporën hebraike të mbledhur nga mesi i kombeve. (shih Ezek 20, 37-38 dhe 34,17.22). 17 Tani grigja ime, unë, Zoti, do ta gjykojë secilin nga ju dhe do t'i veçojë njerëzit e mirë nga njerëzit e këqij, delet nga dhitë. (20,37) "Unë do të t'ju shtie në dorë dhe do të bëj që t'i bindeni besëlidhjes sime. Unë do të heq prej jush ata që janë rebelë e mëkatarë. Unë do t'i nxjerr nga vendet ku banojnë tani, por nuk do t'i lejoj të kthehen në vendin e Izraelit. Atëherë do të pranoni që unë jam Zoti ". 34,17)

Komploti kundër Jezusit

(Mk 14.1-2; Lk 22.1-2; Gjn 11.45-53)

26 Kur i mbaroi të gjitha këto fjalime, Jezusi u tha nxënësve të tij: ²«Siç e dini, pasnesër është festa e Pashkës dhe Biri i njeriut do të dorëzohet për t'u kryqëzuar.»

³Pastaj kryepriiftërinjtë dhe këshilltarët bënë mbledhje në pallatin e kryepriiftit që quhej Kajfa. ⁴Ata morën vendim ta arrestonin Jezusin fshehtazi e ta vritnin. ⁵«Por kjo nuk duhet të ndodhë (hapur) në kohën e festës», – thanë ata, – «që të mos bëhet ndonjë trazirë në popull.»

Nderimi i Jezusit në Bet-Anje

(Mk 14.3-9; Gj,12.1-8)

⁶Jezusi ishte në Bet-Anje, në shtëpinë e Simonit, të ish-lebrosurit. ⁷Kur po rrinte pranë tryezës, iu afrua një grua. Ajo kishte një enë alabastri plot parfum të shtrenjtë që ia zbrazi mbi kokë. ⁸Nxënësit u zemëruan për këtë veprim e thanë: «Pse të bëhet një shpërdorim i tillë? ⁹Ky parfum mund të shitej shtrenjtë e fitimi t'u jepej të varfërve!»

¹⁰Jezusi e dëgjoi këtë e tha: «Pse e mërzitni këtë grua? Ajo më bëri një shërbim të mirë. ¹¹Të varfrit i keni gjithmonë me vete, por mua nuk më keni përherë. ¹²Ajo e derdhi këtë parfum mbi trupin tim për ta përgatitur atë për varrim. ¹³Ju siguroj se gjithkund në botë ku do të shpallet ky lajm i mirë, do të merret vesh edhe çfarë bëri ajo dhe do të përkujtohet.»

Juda bëhet tradhtar

(Mk 14.10-11; Lk 22.3-6)

¹⁴Pastaj Juda nga Karioti, njëri prej të dymbëdhjetë nxënësve, shkoi te kryepriiftërinjtë ¹⁵dhe u tha: «Çfarë më jepni që t'jua dorëzoj?» Ata i caktuan tridhjetë monedha argjendi. ¹⁶Që atëherë Juda filloi të kërkonte rastin e përshtatshëm për ta tradhtuar.

Përgatitjet për darkën e Pashkës

(Mk 14.12-21; Lk 22.7-14, 21-23; Gjn 13.21-30)

¹⁷Ditën e parë të javës së festës, kur po hahej vetëm buka e ndorme, nxënësit iu afruan Jezusit dhe e pyetën: «Ku dëshiron ta përgatitim darkën e Pashkës?» ¹⁸Ai u përgjigj: «Shkoni te një njeri në qytet – ua dha emrin – dhe i thoni kështu: «Mësuesi ynë thotë: Koha ime po afrohet. Pashkën do ta festoj tek ti,

bashkë me nxënësit e mi.»

¹⁹Nxënësit vepruan sipas urdhrorit të Jezusit dhe e përgatitën darkën e Pashkës.

Darka e fundit

²⁰Kur u ngrys, Jezusi u ul në tryezë bashkë me dymbëdhjetë nxënësit e tij. ²¹Kur po hanin, ai u tha: «Unë e di mirë: njëri prej jush do të më tradhtojë.» ²²Nxënësit u tronditën dhe pyetën njëri pas tjetrit: «A mos jam unë, o Zot?» ²³Jezusi u përgjigj: «Njëri prej tyre që e ngjyen kafshatën në pjatë me mua, do të më tradhtojë. ²⁴Biri i njeriut, vërtet, do të vritet, siç thuhet në Shkrimin e shenjtë. Por mjerë ai njeri që e tradhton Birin e njeriut! Më mirë të mos ishte lindur fare!» ²⁵Pastaj e pyeti edhe Juda, tradhtari i tij: «A mos jam unë, Mësues?» «E the vetë!» – iu përgjigj Jezusi.

Pasha reinterpretohet në dritën e vdekjes së Mesisë

(Mk 14.22-26; Lk 22.14-20; 1Kor. 11.23-25)

²⁶Kur po hanin, Jezusi mori bukën dhe tha lutjen e falënderimit, e ndau bukën, ua dha nxënësve të tij dhe tha: «Merreni, hajeni: ky është trupi im.» ²⁷Pastaj mori kupën, tha lutjen e falënderimit, ua dha nxënësve e u tha: «Pijeni, ju të gjithë! ²⁸Ky është gjaku im që do të derdhet si flijim për shumë veta, që mëkatet e tyre të falen. Me këtë gjak vuloset besëlidhja që lidh Zoti. ²⁹Ju siguroj se që tani e tutje nuk do ta pi më verën e darkës së Pashkës derisa të pi – një verë të re – me ju në mbretërinë e Atit tim.»

³⁰Pastaj kënduan psalmet ♦ e falënderimit dhe u nisën për në malin e Ullinjve.

♦ pjesën e dytë të Hallelit (Ps 115-118).

Jezusi dhe Pjetri

(Mk 14.27-31; Lk 22.31-34; Gjn 13.36-38)

³¹Udhës Jezusi u tha: «Sonte do të dilni të pabesë ndaj meje, sepse në Shkrimin e shenjtë thuhet: *Unë do ta vras bariun, dhe dhentë e kopesë do të shpërndahen!* ³²Pas ringjalljes sime do të shkoj para jush në Galile.»

³³Pjetri e kundërshtoi: «Edhe sikur të tjerët do të dalin të pabesë, unë jo.» ³⁴«Mos u mashtro!» – i tha Jezusi. – «Sonte, para se të këndojë gjeli, do të më mohosh tri herë.» ³⁵Por Pjetri tha: «Këtë, unë nuk do ta bëj kurrë, edhe sikur duhet të vdes me ty.» Kështu thanë edhe të gjithë nxënësit e tjerë.

Në kopshtin e Gatsheimit

(Mk 14.32-42; Lk 22.39-46)

³⁶Pastaj Jezusi shkoi me nxënësit e tij në një kopsht që quhej Gatsheimit. Atje u tha: «Rrini këtu! Unë po shkoj pak më tutje, që të lutem.» ³⁷Mori me vete Pjetrin dhe dy bijtë e Zebedeut. U trishtua dhe filloi të dridhej. ³⁸Pastaj u tha: «Kam një barrë që gati po më mbyt. Qëndroni këtu dhe rrini zgjuar me mua.»

³⁹Pastaj u largua pakëz, ra me fytyrë përtokë dhe iu lut Zotit: «Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë vuajtjesh. Megjithatë, le të bëhet jo si dua unë, por si do ti.»

⁴⁰Pastaj u kthye te nxënësit dhe pa se i kishte zënë gjumi. I tha Pjetrit: «A nuk mund të rrini zgjuar me mua as për një orë të vetme? ⁴¹Rrini zgjuar e lutuni që të mos dështoni në provën e zjarrit që po vjen. Keni qëllime të mira, por jeni njerëz të dobët.»

⁴²Jezusi u largua përsëri dhe u lut: «Ati im, në qoftë se nuk mund të jetë ndryshe dhe unë duhet ta pi këtë kupë vuajtjesh, le të bëhet sipas vullnetit tënd.» ⁴³Kur u kthye, ata po flinin përsëri; i kishin sytë të rënduar.

⁴⁴Jezusi u largua pakëz për herën e tretë dhe u lut duke përsëritur të njëjtat fjalë. ⁴⁵Kur u kthye te nxënësit, u tha: «Akoma po flini e po pushoni? Ja, erdhi çasti; Biri i njeriut do t'u dorëzohet menjëherë armiqve të Zotit. ⁴⁶Ngrihuni në këmbë! Të shkojmë. Ja, po vjen ai që do të më tradhtojë!»

Jezusin e arrestojnë

(Mk 14.43-50; Lk 22.47-53; Gjn 18.3-12)

⁴⁷Pa i mbaruar këto fjalë, u paraqit Juda, njëri prej dymbëdhjetë nxënësve, në krye të një çete njerëzish të armatosur me shpata e me shkopinj. I kishin dërguar kryepërfitorinjtë e këshilltarët.

⁴⁸Tradhtari ishte marrë vesh me ta për shenjë (dalluese): «Atë që do të përshëndes duke e puthur, – u kishte thënë, – është ai! Kapeni!» ⁴⁹Iu afrua menjëherë Jezusit dhe i tha: «Të përshëndes, Mësues!» dhe e puthi. ⁵⁰Jezusi i tha: «Shok, bjeri drejt!» Pastaj të armatosurit u afruan, e kapën Jezusin dhe e arrestuan.

⁵¹Njëri prej shoqëruesve të Jezusit nxori shpatën e vet, i ra shërbëtorit të kryepërfitorit dhe i preu veshin.

⁵²Por Jezusi e urdhëroi: «Ktheje shpatën në mill; sepse të gjithë ata që rrokin shpatën, do të vdesin prej shpatës. ⁵³A nuk e di që mund t'i kërkoj ndihmë Atit e Ai do të më dërgonte menjëherë më shumë se dymbëdhjetë legjione engjëjsh? ⁵⁴Por atëherë si mund të plotësohen profecitë e Shkrimit të shenjtë që thonë se duhet të ndodhë kështu?»

⁵⁵Ndërsa atyre që e kishin arrestuar, Jezusi u tha: «Vërtet ju desh të dilni me shpata e me shkopinj për të

më kapur? Mos jam vallë kriminel? Unë isha çdo ditë te ju në Tempull duke predikuar, por ju nuk më arrestuat. ⁵⁶Por të gjitha këto duhet të ndodhin që të plotësohen fjalët e profetëve.» Pastaj të gjithë nxënësit e braktisën dhe ikën.

Jezusi para këshillit të lartë

(Mk 14.53-65; Lk 22.54-55, 63-71; Gjn 18.13-14, 19-24)

⁵⁷Njerëzit që e kishin arrestuar Jezusin, e çuan atë në pallatin e kryepriiftit, Kajfës, ku ishin mbledhur mësuesit e Ligjit dhe këshilltarët. ⁵⁸Pjetri e ndoqi Jezusin nga larg dhe shkoi në oborrin e kryepriiftit. Atje u ul pranë rojtarëve për të parë se si do të përfundonte puna.

⁵⁹Kryepriiftërinjtë dhe mbarë këshilli kërkonin tashmë ta bënë Jezusin fajtor duke përdorur dëshmi të rreme, që të mund ta dënonin me vdekje. ⁶⁰Por nuk arritën, edhe pse u paraqitën shumë dëshmitarë të rremë. Më në fund u paraqitën dy veta. ⁶¹Ata thanë: "Ky njeri ka thënë: «Unë mund ta rrënoj Tempullin e Perëndisë e ta rindërtoj brenda tri ditësh!»"

⁶²Pastaj kryepriifti u ngrit në këmbë dhe e pyeti Jezusin: «Nuk ke asgjë për të thënë kundër këtyre padive?»

⁶³Por Jezusi heshti. Kryepriifti tha: «Unë po të përbetoj me emrin e Perëndisë së gjallë: A je ti Mesia, Biri i Perëndisë?» ⁶⁴Jezusi iu përgjigj: «Po. Ju siguroj se pas pak do ta shihni Birin e njeriut të ulur në të djathtë të të Gjithëfuqishmit (Zot). Gjithashtu, do ta shihni se si do të vijë mbi retë e qiellit.»

⁶⁵Pastaj kryepriifti grisi rrobat e veta e tha: «Kjo është një sharje kundër Zotit! Nuk na duhen më dëshmitarë! Ju e dëgjuat vetë. ⁶⁶Çfarë vendimi nxirrni ju?» «Meriton vdekjen!» – thirrën ata.

⁶⁷Pastaj filluan ta pështynin në fytyrë dhe ta qëllonin me shpulla. Të tjerët e goditën ⁶⁸dhe u tallën me të duke thënë: «Ti, Mesi, gjeje kush të ra! Megjithatë, ti je profet!»

Pjetri e mohon Jezusin

(Mk 14.66-72; Lk 22.56-62; Gjn 18.15-18, 25-27)

⁶⁹Pjetri ishte ende ulur në oborr, kur iu afrua një shërbëtore e i tha: «Edhe ti ishe me Jezusin, galileasin.»

⁷⁰Pjetri e mohoi para të gjithëve duke thënë: «Nuk po të kuptoj çfarë thua.» ⁷¹Ndërsa po i afrohej derës për të dalë jashtë, e vuri re një shërbëtore tjetër, e cila u tha të pranishmëve: «Edhe ky ishte me Jezusin nga Nazareti.» ⁷²Por Pjetri e mohoi përsëri duke u betuar: «As që e njoh atë njeri!» ⁷³Pak më vonë u afruan ata që ishin aty e thanë: «Sigurisht, edhe ti qenke njëri prej tyre! Ja, të tradhton theksi (galileas)!» ⁷⁴Por Pjetri e mohoi duke u betuar: «Më ndëshkoftë Zoti në qoftë se gënjej! Atë njeri nuk e njoh.»

Në atë çast këndoi gjeli ⁷⁵dhe Pjetrit iu kujtua se çfarë i kishte thënë Jezusi: «Para se të këndojë gjeli, do të më mohosh tri herë.» Doli jashtë dhe qau me hidhërim.

Jezusi para Pilatit

(Mk 15.1; Lk 23.1-2; Gjn 18.28-32)

27 Herët në mëngjes kryepriiftërinjtë dhe këshilltarët morën njëzëri vendim për ta dënuar Jezusin me vdekje. ²E lidhën, e morën me vete dhe ia dorëzuan Pilatit, guvernatorit romak.

Vdekja e Judës

(Vap 1.18-19)

³Kur tradhtari, Juda, mori vesh se Jezusi ishte dënuar me vdekje, e breu ndërgegjija dhe ua ktheu tridhjetë monedhat e argjendta kryepriiftërinjve dhe këshilltarëve.

⁴«Kam bërë mëkat të rëndë.» – u tha ai. – «Do të ekzekutohet një i pafajshëm, të cilin e kam tradhtuar unë.»

«Ç'na duhet neve kjo?» – iu përgjigjën ata. – «Kjo është puna jote!» ⁵Juda i hodhi monedhat e argjendta në Tempull. Pas kësaj doli dhe vari veten.

⁶Kryepriiftërinjtë i mblodhën monedhat e argjendta e thanë: «Nuk është e lejueshme të shtihen në arkë të Tempullit, sepse ato janë çmim gjaku.» ⁷U këshilluan dhe vendosën të blenin me to arën e një poçari për një varrezë pelegrinësh të huaj. ⁸Prandaj ajo arë quhet edhe sot: Ara e Gjakut.

⁹Kështu u plotësua profecia e Jirmijës: *Morën të tridhjetë monedhat e argjendit, sipas çmimit me të cilin e vlerësonin izraelitët,* ¹⁰dhe i shpenzuan për arën e poçarit, siç kishte urdhëruar vetë Zoti.

Pilati e merr Jezusin në pyetje

(Mk 15.2-5; Lk 23.3-5; Gjn 18.33-38)

¹¹Jezusi ishte para guvernatorit. Ai e pyeti: «A je ti mbreti i hebrenjve?» «Po», – iu përgjigj Jezusi. ¹²Por kur e paditnin kryepriiftërinjtë dhe këshilltarët, heshtte. ¹³Prandaj Pilati e pyeti: «A nuk po dëgjon se çfarë thonë kundër teje?» ¹⁴Por Jezusi heshti dhe nuk tha asnjë fjalë. Guvernatori u çudit shumë për këtë.

Dënimi me vdekje

(Mk 15.6-15; Lk 23.13-25; Gjn 18.39-19.16)

¹⁵Për festën e Pashkës guvernatori e kishte zakon t'ia falte dënimin një të burgosuri – atë që do të caktonte

populli. ¹⁶Në atë kohë ishte i burgosur një terrorist i përmendur, që quhej (Jezus) Bar-Aba. ¹⁷Pilati i pyeti ata që ishin mbledhur: «Cilin dëshironi të liroj: (Jezus) Bar-Abën apo Jezusin që quhet Mesia?» ¹⁸E tha këtë, sepse e dinte fare mirë se Jezusin, Mesinë, e kishin dorëzuar nga smira. ¹⁹Ndërsa Pilati po rrinte në gjykatore, gruaja e tij e porositi: «Mos u përziej fare në çështjen e atij njeriut të pafajshëm. Mbrëmë e pashë atë në një ëndërr të tmerrshme.» ²⁰Ndërkohë kryepriiftërinjtë dhe këshilltarët po e bindnin popullin që të kërkonte lirimin e Bar-Abës dhe vdekjen e Jezusit. ²¹Gubernuratori i pyeti edhe një herë: «Cilin prej këtyre të dyve doni t'ju liroj?» «Bar-Abën!» – thirrën ata. ²²«E ç'të bëj me Jezusin që quhet Mesia?» «Të kryqëzohet!» – thirrën të gjithë. ²³«Çfarë krimi ka bërë?» – i pyeti. Por ata bërtitën edhe më fort: «Të kryqëzohet!» ²⁴Kur Pilati pa se nuk po arrinte asgjë e se pështjellimi i turmës po vinte duke u shtuar, mori ujë dhe, në sy të popullit, lau duart duke thënë: «Unë jam i pafajshëm për vdekjen e këtij njeriu. Ju do të përgjigjeni për këtë!» ²⁵Mbarë populli thirri: «Në qoftë se ai është i pafajshëm, atëherë dënimi për vdekjen e tij rëntë mbi ne dhe mbi fëmijët tanë!» ²⁶Pastaj e liroi Bar-Abën. Urdhëroi që Jezusin ta fshikullonin dhe ta kryqëzonin.

Ushtarët tallen me Jezusin

(Mk 15.16-20; Gjn 19.2-3)

²⁷Ushtarët e guvernatorit e sollën Jezusin në kështjellë dhe mblodhën rreth tij mbarë repartin. ²⁸E zhveshën dhe i hodhën krahëve një mantel të kuq, ²⁹thurën një kurorë me degë ferrash dhe ia vendosën në kokë. Në dorën e djathtë i dhanë një shkop dhe ranë në gjunj para tij për t'u tallur me të. «Rroftë, mbreti i hebrenjve!» – thërritnin ata. ³⁰Pastaj filluan ta pështynin, ia morën shkopin e i ranë me të kokës. ³¹Pasi u tallën mjaft me të, ia hoqën mantelin e kuq, e veshën me rrobat e tij dhe e shpunë për ta kryqëzuar.

Jezusi në kryq

(Mk 15.21-32; Lk 23.26-43; Gjn 19.17-27)

³²Udhës, ndërsa po dilnin nga qyteti, takuan një njeri nga Cireneja me emrin Simon dhe e detyruan atë të mbante kryqin e Jezusit. ³³Kështu arritën në vendin e quajtur *Gulgoltha* – d.m.th. Kafka. ³⁴Atje i dhanë Jezusit të pinte verë të përzier me vrer narkotik, por, pasi e provoi, nuk pranoi ta pinte. ³⁵E gozhduan në kryq dhe ndanë me short ndërmjet tyre rrobat e tij [kështu u plotësua fjala e profetit (Davidit): *I ndanë rrobat e mia dhe hodhën short për tunikën time*]. ³⁶Pastaj u ulën për ta ruajtur. ³⁷Mbi kokë i kishin vënë një tabelë në të cilën ishte shkruar arsyeja e dënimit: «Ky është Jezusi, mbreti i hebrenjve!» ³⁸Pastaj gozhduan në kryq pranë Jezusit dy terroristë, njërin në të djathtë e tjetrin në të majtë. ³⁹Kalimtarët tundnin kokën dhe shanin Jezusin: ⁴⁰«Ti doje ta rrënoje Tempullin e ta rindërtoje atë brenda tri ditësh! Në qoftë se je Biri i Perëndisë, atëherë çlirohu e zbrit nga kryqi!» ⁴¹Po ashtu edhe kryepriiftërinjtë, mësuesit e Ligjit dhe këshilltarët u tallën me të: ⁴²«Të tjerët i ndihmoi, kurse veten e tij nuk mund ta ndihmojë. Në qoftë se ai është me të vërtetë mbreti i Izraelit, le të zbresë tani nga kryqi! Atëherë do ta besojmë!» ⁴³Ka shpresuar në Perëndinë, le ta ndihmojë Ai tani, në qoftë se e do, sepse vetë tha: Jam Biri i Perëndisë!» ⁴⁴Po ashtu e shanë edhe dy terroristët që ishin kryqëzuar bashkë me të.

Vdekja e Jezusit

(Mk 15.33-41; Lk 23.44-49; Gjn 19.28-30)

⁴⁵Që nga mesdita deri në orën tre mbarë tokën e mbuloi errësira. ⁴⁶Rreth orës tre, Jezusi klithi me zë të lartë: «*Eli, Eli! Lama sabakthani?*» – që do të thotë 'Perëndia ime, Perëndia ime, përse hoqe dorë prej meje?' ⁴⁷Disa prej atyre që qëndronin aty dhe e dëgjuan, thanë: «Ky po thërret Eljën!» ⁴⁸Njëri prej tyre gjeti shpejt një sfungjer, e zhyti në uthull, e vari në shkop dhe ia shtriu Jezusit ta pinte. ⁴⁹Të tjerët thirrën: «Ndal! Le të shohim nëse do të vijë Elija për ta ndihmuar.» ⁵⁰Por Jezusi bërtiti edhe një herë me zë të lartë e dha shpirt. ⁵¹Pastaj perdja që gjendej para shenjtërores së brendshme të Tempullit, u gris në dy pjesë nga lart poshtë. Toka u lëkund dhe shkëmbinjtë plasaritën, ⁵²varret u hapën dhe prej popullit të Perëndisë u ringjallën shumë veta që kishin vdekur. ⁵³Më vonë, pas ringjalljes së Jezusit, ata erdhën në Jerusalem dhe iu shfaqën shumë vetave. ⁵⁴Kapitenin dhe ushtarët që po ruanin Jezusin, i kapi një frikë e madhe. Kur panë tërmetin dhe ngjarjet e tjera, thanë: «Ky paska qenë me të vërtetë Biri i Perëndisë!» ⁵⁵Aty kishte edhe shumë gra, të cilat vështronin gjithçka nga larg. Ato e kishin shoqëruar Jezusin që nga Galileja dhe ishin kujdesur për të. ⁵⁶Ndër të ishin Maria nga Magdala, Maria, nëna e Jakobit dhe e Jozefit, si dhe nëna e të dy bijve të Zebedeut.

Varrimi i Jezusit

(Mk 15.42-47; Lk 23.50-56; Gjn 19.38-42)

⁵⁷Kur u err, erdhi një pasanik nga Ramataimi; quhej Jozef dhe ishte nxënës i Jezusit. ⁵⁸Shkoi te Pilati dhe

iu lut për trupin e Jezusit. Pilati urdhëroi që t'i dorëzohej. ⁵⁹Jozefi e mori trupin, e mbështolli në një pëlhurë të pastër ⁶⁰dhe e vendosi në varrin e tij të ri që kishte hapur në shkëmb. Pastaj rrokullisi në grykën e varrit një gur (mulliri) të madh dhe iku. ⁶¹Maria nga Magdala dhe Maria tjetër po rrinin aty ulur përballë varrit.

Roja e varrit

⁶²Të nesërmen ishte ditë e shtunë. Kryepriiftërinjtë e farisenjtë shkuan së bashku te Pilati ⁶³dhe i thanë:

«Zotëri, na u kujtua se ai mashtrues, sa ishte ende gjallë, tha se do të ringjallet tri ditë pas vdekjes.

⁶⁴Prandaj jep urdhër që varri të ruhet deri në ditën e tretë. Përndryshe, ndoshta nxënësit e tij do të vijnë ta vjedhin trupin e do t'i thonë popullit se u ringjall. Atëherë ky mashtrim i fundit do të jetë edhe më i keq se gënjeshtat e mëparshme.» ⁶⁵«Rojën e keni!» – tha Pilati. – «Shkoni e sigurojeni varrin si të mendoni vetë!»

⁶⁶Ata shkuan te varri, e vulosën gurin në grykë dhe vunë rojë.

Ringjallja e Jezusit

(Mk 16.1-10; Lk 24.1-12; Gjn 20.1-10)

28 Në mbrëmje, kur kaloi e shtuna dhe po agonte e diela, Maria nga Magdala u nis bashkë me Marinë tjetër për t'u kujdesur për varrin. ²Papritur toka u tund nga tërmeti, sepse engjëlli i Zotit zbriti nga qielli, iu afrua varrit, rrokullisi gurin dhe u ul mbi të. ³Fytyra i ndriti si vetëtima dhe petkun e kishte të bardhë si bora. ⁴Rojtarët u trembën aq shumë, saqë u drodhën dhe u ra nuri i vdekjes.

⁵Engjëlli u tha grave: «Mos u trembni! E di se kërkonti Jezusin, të cilin e kryqëzuan. ⁶Ai nuk është këtu! U ringjall, ashtu siç tha! Afrohuni e shikoni vendin ku ishte vendosur! ⁷Tani shkoni shpejt te nxënësit e tij dhe tregojuni se Zoti e ringjalli nga të vdekurit! Po shkon përpara jush në Galile. Atje do ta shihni. Kini besim te fjala ime.»

⁸Ato menjëherë u larguan nga varri me frikë, por megjithatë, me gëzim të madh. Shkuan me nxitim për të lajmëruar nxënësit e tij. ⁹Papritur Jezusi u ndodh para tyre dhe u tha: «Ju përshëndes!» Gratë ranë përmbys para tij dhe i shtrënguan këmbët. ¹⁰«Mos kini frikë» – u tha Jezusi. – «Shkoni e lajmëroni nxënësit e mi që të shkojnë në Galile. Atje do të më shohin.»

Raporti i rojës

¹¹Ndërsa gratë ishin ende në rrugë, disa nga rojtarët u kthyen me vrap nga varri dhe shkuan në qytet. Ata i njoftuan kryepriiftërinjtë për atë që kishte ndodhur. ¹²Këta u morën vesh me këshilltarët se çfarë të bënin. Ata i blenë ushtarët me shumë para ¹³dhe i urdhëruan: »Thoni: «Nxënësit e tij erdhën natën e, ndërsa ne po flinim, vodhën trupin». ¹⁴Në rast se guvernatori e merr vesh, ne do ta rregullojmë çështjen me të. Ju nuk keni përse të frikësoheni!» ¹⁵Rojtarët i morën paratë dhe vepruan sipas urdhrit. Kjo përrallë ♦ është e përhapur ndër hebrejtë edhe sot e kësaj dite.

♦ d.m.th. ajo që treguan ushtarët pasi i kishin blerë kryepriiftërinjtë. Është kuptimplote se nuk u ra ndër mend të pretendonin se dikush tjetër e kishte zëvendësuar Jezusin në kryq.

Jezusi i dërgon apostujt në mbarë botën

(Mk 16.14-18; Lk 24.36-49; Gjn 20.19-23; Vap 1.6-8; 1 Kor 15,6)

¹⁶Të njëmbëdhjetë nxënësit shkuan në Galile, në malin që kishte caktuar Jezusi. ¹⁷Kur e panë atje, ranë përmbys para tij, por disa e bënë këtë me mëdyshe. ¹⁸Jezusi iu afrua atyre dhe u tha: «Zoti më ka dhënë fuqi të plota e të pakufizuara në qiell dhe në tokë. ¹⁹Prandaj shkoni e bëjini të gjithë popujt nxënës të mi! Pagëzojini në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit të shenjtë, ²⁰dhe mësojini të zbatojnë gjithçka që ju kam urdhëruar! Ta kini të qartë: Unë jam me ju gjithmonë, deri në mbarimin e kësaj epoke!» ♦

♦ Çifutët e ndanë historinë në këtë epokë dhe në epokën (mesianike) që do të vijë.